



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 82

Tiranë – E premte, 22 maj 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 20.5.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 321, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”..... 4307
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 1, datë 19.1.2014	Për përcaktimin e drejtimeve prioritare të investimeve dhe miratimin e Dokumentit Strategjik Operacional për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, 2015-2016..... 4318
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 6, datë 9.2.2015	Për administrimin “tranzitor” të projekteve me autoritet kontraktues komunat, në periudhën shkurt- shtator 2015..... 4358

**VENDIM****Nr. 436, datë 20.5.2015****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.321, DATË 28.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SIGURINË NË DET, PLAZHE, NË UJËRAT E BRENDSHME NË THELLËSI TË TERRITORIT DHE GJATË USHTRIMIT TË SPORTEVE UJORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.9861, datë 24.1.2008, “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, të ndryshuar, të nenit 4/a, të ligjit nr.8663, datë 18.9.2000, “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nën 20 NT”, të ndryshuar, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të nenit 3, të ligjit nr.8905, datë 6.6.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, të ndryshuar, të ligjit nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, dhe të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.321, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “ç”, e pikës 3, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) “Stacion plazhi”, veprimtari turistike e ushtruar në struktura lehtësisht të çmontueshme, të ndodhura pranë bregut të detit, të liqeneve ose lumenjve, të pajisura me kabina për plazh, dhoma zhveshjeje, shërbime higjienike, dushe dhe, sipas rastit, edhe me pajisje për ruajtjen dhe ofrimin e ushqimeve e pijeve, si dhe shërbime për sigurinë e pushuesve.”.

2. Shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 2, të kreut II, “Detyrimet e institucioneve përgjegjëse”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) Identifikimin e zonave të përshtatshme për plazhe si zona çlodhëse, argëtuese dhe ushtrimin e sporteve ujore, për përdorim publik, të konsideruara të parrezikshme për njerëzit nga pikëpamja shëndetësore/higjienike apo e sigurisë.

c) Dhënien me qira të hapësirës së plazheve personave fizikë e juridikë, për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit:

- për një sipërfaqe jo më të vogël se 5 000 (pesë mijë) m², në rastin e plazheve me gjerësi më të madhe se 100 (njëqind) m, dhe për plazhet e tjera në varësi të terrenit;

- për një afat kohor 4-mujor.

Poseduesit e lejeve janë të detyruar të marrin dhe të zbatojnë me korrektësi të gjitha masat e parashikuara për sigurinë dhe shëndetin. Inspektimi i këtyre zonave do të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me institucionet e tjera që ngarkon me përgjegjësi ky vendim, sipas shtojcës A-1.

Plazhet që nuk janë përmendur në shtojcën A-1 nuk mund të jenë subjekt autorizimi.”.

3. Shtojca A-1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me shtojcën A-1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kudo në këtë vendim emërtimi “Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit” zëvendësohet me fjalët “Ministria përgjegjëse për turizmin”.

II. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



SHTOJCA A
A-1
ZONAT E IDENTIFIKUARA PËR TËU AUTORIZUAR PËR PËRDORIM PUBLIK NË
BREGDETIN SHQIPTAR DHE UJËRAT NË BRENDESI TË TERRITORIT
(Lista, Koordinatat, Hartat)

Nr. rendor	Nr. Kord	Plazhet	x	y
1	1	Plazhi i Velipojës	367882.7	4635417.4
2	2	Plazhi i Velipojës	370879.3	4635231.1
3	1	Plazhi i Shëngjinit	383017.1	4629870.0
4	2	Plazhi i Shëngjinit	383803.2	4628015.1
5	1	Plazhi i Tales	382002.5	4619791.4
6	2	Plazhi i Tales	381645.7	4615499.0
7	1	Plazhi i Gjirit të Lalzit	375335.5	4599834.8
8	2	Plazhi i Gjirit të Lalzit	375853.2	4595326.2
9	1	Plazhi Rrushkull	374321.0	4591441.4
10	2	Plazhi Rrushkull	372072.4	4588931.1
11	1	Plazhi Hamallaj	374338.0	4591460.6
12	2	Plazhi Hamallaj	375849.7	4595184.3
13	1	Plazhi i Katundit të Ri	370430.8	4587524.8
14	2	Plazhi i Katundit të Ri	369312.8	4585230.5
15	1	Plazhi Currila 4	368160.8	4575841.6
16	2	Plazhi Currila 4	368286.0	4575796.8
17	1	Plazhi Currila 5	368562.9	4575627.2
18	2	Plazhi Currila 5	369148.3	4574403.5
19	1	Plazhi i Durrësit	371942.3	4574789.1
20	2	Plazhi i Durrësit	375118.5	4571538.4
21	1	Plazhi i Rrashbullit	375146.6	4571493.0
22	2	Plazhi i Rrashbullit	375893.9	4569375.4
23	1	Plazhi Golem	375294.3	4565378.1
24	2	Plazhi Golem	375894.0	4569372.8
25	1	Plazhi Qerret	375287.2	4565355.7
26	2	Plazhi Qerret	374498.9	4563812.6
27	1	Plazhi i Gjeneralit	369756.5	4554319.0
28	2	Plazhi i Gjeneralit	369791.5	4553998.3
29	1	Plazhi i Spillesë	370445.5	4551020.2
30	2	Plazhi i Spillesë	370152.4	4546821.9
31	1	Plazhi i Divjakës	370553.4	4534447.9
32	2	Plazhi i Divjakës	371563.5	4537884.2
33	1	Plazhi Seman 1	362890.3	4516306.7
34	2	Plazhi Seman 1	362458.5	4513614.3
35	1	Plazhi Pishë Pore	361823.5	4508305.7
36	2	Plazhi Pishë Pore	359778.8	4504794.1
37	1	Plazhi Vjetër	369005.7	4480957.0





38	2	Plazhi Vjetër	371180.7	4479083.2
39	1	Plazhi Uji Ftohtë-Jonufër	372105.0	4476475.8
40	2	Plazhi Uji Ftohtë-Jonufër	371166.5	4474953.1
41	1	Plazhi Radhimë	371148.6	4474918.9
42	2	Plazhi Radhimë	370671.9	4466830.0
43	1	Plazhi Orikum 1	370053.4	4466737.2
44	2	Plazhi Orikum 1	369827.6	4466152.3
45	1	Plazhi Orikum 2	369620.3	4465825.4
46	2	Plazhi Orikum 2	368424.2	4465040.1
47	1	Plazhi Dhërmi 1	380819.1	4446370.5
48	2	Plazhi Dhermi 1	382245.6	4445277.0
49	1	Plazhi Dhërmi 1	383515.4	4444663.4
50	2	Plazhi Dhërmi 1	384798.2	4443596.0
51	1	Plazhi Jale	389262.8	4441956.3
52	2	Plazhi Jale	389343.9	4441662.5
53	1	Plazhi Livadhe	390844.8	4440733.9
54	2	Plazhi Livadhe	391799.3	4439995.6
55	1	Plazhi Himarë 1	392739.1	4439727.7
56	2	Plazhi Himarë 1	393235.6	4439596.7
57	1	Plazhi Himarë 1	393311.1	4439565.1
58	2	Plazhi Himarë 1	393440.1	4439449.7
59	1	Plazhi Potam	393545.8	4439460.1
60	2	Plazhi Potam	393805.5	4438592.9
61	1	Plazhi Llaman	394788.7	4437450.6
62	2	Plazhi Llaman	394929.4	4437342.9
63	1	Plazhi Qeparo 1	398744.6	4434141.7
64	2	Plazhi Qeparo 1	399112.7	4434200.2
65	1	Plazhi Qeparo 2	399298.0	4434252.8
66	2	Plazhi Qeparo 2	400227.1	4434147.6
67	1	Plazhi i Borshit	400741.8	4434121.2
68	2	Plazhi i Borshit	404018.4	4431075.3
69	1	Plazhi i Bunecit	405206.0	4429134.7
70	2	Plazhi i Bunecit	405529.7	4428420.1
71	1	Plazhi Lukovë 1	406304.4	4426931.1
72	2	Plazhi Lukovë 1	406373.8	4426482.0
73	1	Plazhi Lukovë 1	407100.8	4425709.5
74	2	Plazhi Lukovë 1	407167.4	4425503.3
75	1	Plazhi Lukovë 1	407187.5	4425443.2
76	2	Plazhi Lukovë 1	407205.2	4425011.7
77	1	Plazhi Kakome	409307.5	4420300.9
78	2	Plazhi Kakome	409171.0	4420034.4
79	1	Plazhi Sarandë 1	414695.6	4413704.8
80	2	Plazhi Sarandë 1	413713.9	4413973.7





81	1	Plazhi Sarandë 1	415070.0	4414162.5
82	2	Plazhi Sarandë 1	414771.7	4414063.3
83	1	Plazhi Sarandë 1	415648.2	4413986.6
84	2	Plazhi Sarandë 1	415270.9	4414206.7
85	1	Plazhi Sarandë 1	415728.6	4413587.0
86	2	Plazhi Sarandë 1	415681.5	4413871.7
87	1	Plazhi Sarandë 1	415819.1	4413446.0
88	2	Plazhi Sarandë 1	415851.7	4413402.3
89	1	Plazhi Sarandë 1	415995.4	4413029.4
90	2	Plazhi Sarandë 1	415894.6	4413084.2
91	1	Plazhi Sarandë 1	416204.8	4411937.1
92	2	Plazhi Sarandë 1	416143.4	4412184.7
93	1	Plazhi Sarandë 1	416267.2	4411903.2
94	2	Plazhi Sarandë 1	416213.2	4411702.1


Hartat e plazheve





















Tabela 1. Pesha specifike referuese e drejtimeve prioritare, programeve dhe nënprogrameve për zhvillimin e rajoneve

Nr.	Drejtimet prioritare	Programi	Nënprogrami/Masa	Pesha specifike referuese
1	Zhvillimi i infrastrukturës rajonale të aksesit	Infrastruktura vendore	Përmirësimi i aksesit dhe lëvizshmërisë	20%
			Rivitalizimi i poleve urbane dhe qendrave rajonale	
			Plane të integruara zhvillimore, rajonale dhe ndër-rajonale	
2	Kohezioni dhe Bashkëpunimi Rajonal	Infrastruktura vendore	Përmirësimi i infrastrukturës dhe promovimi i atraksioneve turistike	20%
			Përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës lidhëse ndërvendore	
			Rehabilitim i mjediseve kulturore-artistike, të ndërtuara	
		Rehabilitim mjedisor	Pasurimi dhe gjallërimi i parqeve rajonale, ndërkufitare	
		Arsimi dhe Sporti	Edukim cilësor, trajnim dhe formim profesional	
			Riaktivizim i stadioneve sportive me qëllim zhvillimin e aftësive	
		Furnizimi me ujë dhe sistemi i kanalizimeve	Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe shpërndarjes, në funksion të zhvillimit të turizmit	
3	Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Cilësia e Jetës	Infrastruktura vendore	Përmirësimi i infrastrukturës vendore dhe ndërvendore	40%
			Rehabilitimi i fasadave dhe objekteve më rëndësi të veçantë historike, ekonomike	
		Rehabilitim mjedisor	Gjelbërimi i akseve rrugore dhe shesheve urbane	
			Rehabilitimi i zonave të degraduara mjedisore	
		Arsimi dhe Sporti	Përmirësimi i cilësisë së arsimit bazë (rehabilitim, ndërtim shkollash)	
			Përmirësimi i cilësisë së arsimit mesëm (rehabilitim, ndërtim shkollash)	
			Arsimi i lartë	
			Shkolla - Qendër komunitare (terrenet sportive)	
		Shëndetësia	Përmirësimi i shërbimit parësor shëndetësor	
		Furnizimi me ujë dhe sistemi i kanalizimeve	Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve	
			Furnizimi me ujë, si arëdim urban (çezmat publike)	
		Art-Kulturë	Ndërtimi i qendrave multifunksionale	
			Rikualifikimi dhe fuqizimi i strukturave të artit dhe kulturës	



4	Konvergjencia dixhitale	Përmirësimi dhe modernizimi i shërbimeve publike	Krijimi dhe plotësimi i regjistrave bazë të të dhënave të institucioneve për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut	15%
			Ndërtimi i portalit të të dhënave, në funksion të transparencës, komunikimit dhe ndërveprimit me publikun, nëpërmjet sistemeve të TIK.	
			Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës dixhitale në funksion të shërbimeve ndaj publikut dhe biznesit (të ofruara nga pushteti qendror e lokal).	
			Përmirësimi i ndërlidhjes dhe ndërveprimit të platformave dixhitale të komunikimit.	
			Reformimi dhe dixhitalizimi i shërbimeve, në qendrat unike të shërbimeve të integruara.	
		Reforma e manaxhimit të tokës	Ngritja e kadastrës shumëqëllimshë	
		Reforma strukturore për uljen e informalitetit në ekonomi	Miradministrimi dhe optimizimi i shpenzimeve buxhetore	
			Përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave buxhetore.	
		Rritja e kapaciteteve njerëzore përmes përdorimit të teknologjive të reja	TIK në arsim (parashkollor, ciklin e ulët, të mesëm dhe të lartë)	
			TIK në administratën publike dhe pushtetin vendor	
5	Asistenca teknike			5%
Totali				100%



**PROGRAMI OPERACIONAL
PËR ZHVILLIMIN RAJONAL
2015-2016**

**NJËSIA E BASHKËRENDIMIT TË PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT DHE PLANIFIKIMIT
STRATEGJIK**

I. HYRJE

Programi Operacional për Fondin për Zhvillimin e Rajoneve është dokumenti kuadër për funksionimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për periudhën 2015-2016. Ky program mbështetet në Programin e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, strategjitë sektoriale e ndërsektoriale, si edhe dokumente të tjerë me rëndësi për planifikimin strategjik të vendit.

Dokumenti është hartuar nga Njësia e Planifikimit Strategjik, në përputhje me detyrimet në kuadër të Ligjit nr. 160, “Për buxhetin e vitit 2015”, datë 27.11.2014, aneksi 3, i cili specifikon modalitetet e funksionimit të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

II. KUADRI STRATEGJIK I POLITIKËS SË ZHVILLIMIT RAJONAL

Zhvillimi rajonal në vend karakterizohet nga një zhvillim i pabarabartë ndërmjet rajoneve të vendit, si dhe mungesa e konvergencës në kontekstin ndërkombëtar (sidomos në lidhje me BE-në). Zhvillimi midis rajoneve të vendit, ndërmjet bashkive dhe komunave, por dhe midis zonave rurale e urbane, si dhe gjithashtu mes zonave bregdetare dhe malore periferike të vendit mbeten ende të pabarabartë. Migrimi si brenda dhe jashtë vendit mbetet ende një çështje kritike. Vihet re një mbipopullim në zonat e zhvilluara dhe shpopullimi i disa zonave, duke sjellë përdorimin joefikas të infrastrukturës dhe shërbimeve.

Kjo situatë zhvillimore mbështetet në një kuadër jo të plotë të politikave dhe kapacitete të kufizuara institucionale. Korniza e politikave duhet konsoliduar, ndërsa kapacitetet në lidhje me menaxhimin e zhvillimit rajonal nevojitet të orientohen drejt një qasje të re, për të rritur eficiencën dhe efektivitetin. Lidhja ndërmjet niveleve të ndryshme të planifikimit strategjik dhe zbatimit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal mbetet ende e dobët.

Në vijim pasqyrohen disa aspekte në përgjithësi të lidhura me situatën aktuale të zhvillimit rajonal të vendit.

1 Politika Rajonale e BE-së për Zhvillimi Rajonal

Komponenti për zhvillimin rajonal mbështet politikat e zhvillimit rajonal dhe përgatitjen për administrimin dhe zbatimin e politikës së Kohezionit të Bashkimit European. Në mënyrë të veçantë:

Në 1974 në Samitin e Parisit liderët politikë vendosën të formojnë Fondin Evropian për Zhvillim Rajonal (1975). Ky fond u fokusua për të stimuluar aktivitetet ekonomike dhe përmirësimin e infrastrukturës në rajonet më pak të zhvilluara.



Në vitet 1988-1993 fondet strukturore u integruan drejt një politike gjithëpërfshirëse kohezionale, duke u fokusuar në rajonet më të varfra dhe më të prapambetura, drejt programeve, orientimeve të investimeve strategjike si dhe në përfshirjen e partneritetit rajonal dhe lokal. Buxheti i alokuar arrinte në 64 bilion euro.

Në vitet 1994-1999, përmes Traktatit të Mastrihtit (1993) u futën tri risi:

- Fondi i Kohezionit
- Komiteti i Rajoneve
- Parimi i Subsidiaritetit

Gjatë kësaj periudhe burimet për fondet strukturore dhe të kohezionit u dyfishuan, duke arritur një të tretën e buxhetit të BE-së (168 bilion euro).

Në periudhën 2000-2006 strategjia e Lisbonës (viti 2000) përcaktoi prioritetet e BE-së në drejtim të rritjes, hapjes së vendeve të punës dhe inovacionit. Buxheti i alokuar për 15 vendet anëtare ekzistuese (213 bilion euro), ndërsa për vendet e reja anëtare (22 bilion euro).

Në periudhën 2007-2013 buxheti i alokuar ishte 347 bilion euro (e cila 25% ishte destinuar për hulumtim dhe inovacion dhe 30% për infrastrukturën e mjedisit dhe masave për të luftuar ndryshimet klimaterike). Ky investim synonte të nxiste rritjen rajonale dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Madje edhe strategjia “Europa 2020”, e cila paraqet një projektion 10-vjeçar të komunitetit, vazhdon të shënjestrojë objektivat e Politikës së Kohezionit, me qëllim realizimin e një rritjeje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Strategjia “Europa 2020” nuk prek vetëm vendet anëtare të BE-së por përkundrazi, ofron një mbështetje të konsiderueshme edhe për vendet kandidate dhe kandidate potenciale, dhe i ndihmon ato të projektojnë përpjekjet e tyre për reforma. Kjo sigurisht nënkupton që vendet anëtare, dhe jo vetëm, duhet të përpiqen të përkthejnë objektivat e BE-së në objektivat e veta kombëtarë.

Si pjesë e objektivave për të promovuar zhvillimin rajonal, FEZHR dha kontribut drejt financimit kryesisht të masave të mëposhtme:

Konvergjenca:

- Modernizimin dhe diversifikimin e strukturave ekonomike,
- Krijimi e qëndrueshëm të vendeve të punës ,



- Stimulimin e rritjes ekonomike,
- Përmirësimin e zonave urbane, malore, më pak të banuara etj.

Konkurrenca rajonale dhe punësimi:

- Inovacioni dhe njohuri ekonomi (p.sh. hulumtim dhe zhvillim teknologjik, risi dhe sipërmarrje etj.),
- Mjedisi dhe parandalimi i rrezikut (p.sh., pastrimin e zonave të ndotura, efikasiteti i energjisë, transporti urban, planet e parandalimit të rrezikut),
- Qasje në transport dhe telekomunikacion - bashkëpunimi territorial,
- Aktivitetet ndërkufitare ekonomike, sociale, mjedisore dhe bashkëpunimin transnacional, duke përfshirë bashkëpunimin bilateral ndërmjet rajoneve,
- Bashkëpunimi ndër-rajonal, duke përfshirë krijimin e rrjeteve dhe shkëmbimin e përvojave në mes të autoriteteve rajonale dhe lokale.

Në periudhën 2014-2020 buxheti i alokuar është 351.8 bilion EUR me një fokus të veçantë në katër prioritetet kryesore të investimit: hulumtimin dhe inovacionin, agjendën digjitale, mbështetjen për SME-të dhe ekonominë e ulët e karbonit. Rreth 100 bilion EUR do të jetë e dedikuar për këta sektorë, nga të cilat 26.7 bilion EUR do të mbështesë kalimin në një ekonomi të ulët të karbonit (eficiencën e energjisë dhe energjinë e rinovueshme). FEZHR do të investojë për të nxitur konkurrencën dhe për të krijuar vende pune në të gjitha rajonet e BE-së. Veprimet FEZHR janë të perceptuar për të adresuar sfidat ekonomike, mjedisore dhe sociale, me fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm urban (mbi 50% e investimit do të jetë në zonat urbane).

FEZHR për 2014-2020 fokuson investimet në disa fusha prioritare. Kjo është e njohur si “përqendrimet tematike” :

- Inovacioni dhe hulumtim;
- Axfenda digjitale;
- Mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME);

Ekonominë e ulët të karbonit:

Burimet e alokuara të FEZHR-së në këto prioritete do të varen nga kategoria e rajonit:



- Në rajonet më të zhvilluara, të paktën 80% e fondeve do të përqëndrohen në të paktën dy nga këto prioritete;
- Në rajonet në tranzicion 60% e fondeve;
- Në rajonet më pak të zhvilluara 50%.

Për më tepër, disa burime të FEZHR do të kanalizohen në mënyrë specifike ndaj projekteve për një ekonomi më të ulët të karbonit:

- Rajone të zhvilluara: 20%;
- Rajonet e tranzicionit: 15% dhe
- Më pak të zhvilluar: 12%.

Karakteristikat specifike territoriale

- FEZHR gjithashtu i jep vëmendje të veçantë karakteristikave specifike territoriale. Masat e FEZHR janë projektuar për të reduktuar problemet ekonomike, mjedisore dhe sociale në zonat urbane me fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm urban. Të paktën 5% e burimeve të FEZHR-së janë të vendosura përmes “veprime të integruara” të menaxhuara nga qytetet.
- Zonat e disavantazuara nga një këndvështrim gjeografik (zonat e largëta malore ose zonat me popullsi të ulët) përfitojnë nga trajtimi i veçantë. Së fundmi, zonat larg qendrës gjithashtu përfitojnë nga ndihma specifike e FEZHR-së për të trajtuar disavantazhet e mundshme për shkak të largësisë së tyre.

POLITIKA E KOHEZIONIT



Figura 1 Evolimi i qasjes Rajonale të Bashkimit Evropian



Figura 2. Programimi i Fondit Evropian për Zhvillimin e Rajoneve (FERZH)



2 Kuadri Ligjor për Zhvillimin Rajonal

Aktualisht, nuk ka një kuadër të plotë ligjor për zhvillimin rajonal në Shqipëri. Gjithsesi, ekzistojnë ligje apo akte nënligjore që të gjitha së bashku mund të formojnë një paketë legjislative që mund të shërbejë si bazë për zhvillimin rajonal. Pavarësisht, kjo bazë është jo e plotë dhe jo e përshtatur për zhvillimin rajonal në mënyrë specifike dhe sqaron në një masë të caktuar funksionet administrative të Qarkut, që do të thotë, shërbime që mund të kryhen në nivel Qarku/ nivel rajonal etj. Kompetencat dhe kapacitetet e qarqeve lidhur me menaxhimin e zhvillimit rajonal mbeten të kufizuara.

Kushtetuta e Shqipërisë përcakton qarkun si nivel të dytë të qeverisjes vendore në Shqipëri dhe si njësi ku politikat rajonale zbatohen dhe harmonizohen me politikat kombëtare. Sipas Ligjit nr 8652, datë 2000/07/31, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (neni 13), funksionet e qarkut përfshijnë funksionet si hartimin dhe zbatimin e politikave rajonale dhe harmonizimin e tyre me politikat kombëtare në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër që mund të caktohet me ligj.

Ligji organik përcakton Qarkun brenda qeverisjes lokale të nivelit të dytë (neni 5, paragrafi 4), i cili përfaqëson një njësi territoriale dhe administrative që është e përbërë nga disa komuna dhe bashki me interesa të përbashkëta gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale etj. Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Neni 49 i ligjit organik përcakton përbërjen e Këshillit të Qarkut me përfaqësues të komunave dhe bashkive. Ky kuadër ligjor ishte baza për udhëheqjen e reformës territoriale administrative të ndërmarrë nga qeveria gjatë periudhës janar-qershor 2014. Si rezultat i një reforme të tillë ndryshimet territoriale janë organizuar në 61 njësi të qeverisjes vendore të konsoliduara, ndërsa numri dhe organizimi i qarqeve mbetet i njëjtë. Organizimi i qeverisjes vendore në Shqipëri përcaktohet nga Ligji nr. 115, datë 2014/07/31 "Për ndarjen territoriale administrative të qeverisjes vendore në Shqipëri".

Përpyjekjet në fushën e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri, e kanë fillësën e tyre në vitin 2007, pikërisht atëherë kur Ministria e Ekonomisë, në një proces konsultimi të vazhdueshëm me aktorët e interesit, hartoi Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillim Rajonal. Qëllimi i këtij dokumenti strategjik është sigurimi i një qasjeje të koordinuar për një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik të të gjitha rajoneve të vendit, dhe krijimi i lidhjeve midis institucioneve të çdo niveli të qeverisjes dhe grupeve të interesit, për një zhvillim të qëndrueshëm dhe për zvogëlimin e pabarazive social-ekonomike. Për të përmbushur një objektiv të tillë, SNZHR propozonte në këtë dokument hartimin e 2 programeve investimi,

konkretisht: Programin Kombëtar për Zhvillimin e Qarqeve dhe Programin e Zhvillimit të Zonave të Pafavorizuara.

Në nivel institucional, SNZHR propozonte ngritjen e një Agjencie Kombëtare për Zhvillimin Rajonal bashkë me 12 AZHR, një për secilin qark, ngritjen e 12 Këshillave të Partneritetit të Qarkut, si dhe Këshillin e Partneritetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal.

Gjithashtu, SNZHR propozonte hartimin e 12 Strategjive të Zhvillimit në nivel qarku, dhe më në fund një ligj për zhvillimin rajonal dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Që nga viti 2007, kur ajo është formuluar, SNZHR nuk është vënë në zbatim. Pas miratimit të strategjisë, në gusht të vitit 2008, përgatitet drafti i ligjit për Zhvillim Rajonal, por nuk iu dërgua as Këshillit të Ministrave dhe as Parlamentit për miratim.

3 Kuadri Strategjik për Zhvillimin Rajonal

Programi i Qeverisë përcakton si **prioritetet politike** për Rajonalizimin (ndarja e vendit në rajone) dhe Reformën Rajonale. Programi lidhet me: (i) **krijimin e rajoneve dhe rikonfigurimin e qarqeve sipas modeleve europiane të rajoneve dhe vetqeverisjes**; (ii) udhëheqjen e re lidhur me **politikat zhvillimore kombëtare dhe rajonale**; (iii) rritjen e **funksioneve dhe kompetencave të njësive ekonomike** të qeverisë shqiptare në nivel rajonal; (iv) **rritja e burimeve financiare dhe aseteve** në rajonet respektive; (v) **modeli i ri dhe më efikas** për autoritetet qendrore dhe lokale në nivel rajonal; (vi) **reforma vendimtare për përfshirjen e Shqipërisë** si një vend kandidat i BE-së; (vii) mbështetje teknike dhe fonde nga instrumentet e BE-së për fuqizimin e rajoneve. Programi i qeverisë shqiptare në mënyrë të qartë ofron mundësi për krijimin e rajoneve me një autonomi të përcaktuar në përputhje me parimet e Kartës Evropiane.

Ky këndvështrim i orienton rajonet të përqëndrohen në çështjet e zhvillimit rajonal dhe për këtë qëllim të përfitojnë jo vetëm nga burimet e brendshme, por edhe nga burimet e BE-së. Kjo lë hapësirë për një rishikim të gjerë të institucioneve të dekoncentruara në nivel rajonal, duke përfshirë edhe kompetencat e tyre.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) për periudhën 2014-2020 është dokumenti themelor strategjik që po hartohet aktualisht nga Qeveria Shqiptare. SKZHI orienton politikat kombëtare me qëllim arritjen e standardeve të nevojshme për integrimin e vendit në BE, si edhe zhvillimin e vendit. SKZHI përfshin brenda gjithashtu Programin e Qeverisë, “për të transformuar Shqipërinë në një model që



frymëzon paqen dhe zhvillimin në rajon”. SKZHI ofron kornizën strategjike për të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale dhe është shtylla kryesore e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI).

SKZHI paraqet shtyllat kryesore të vizionit të politikës së zhvillimit rajonal në vend, duke orientuar drejt objektivave të mëposhtme:

1. **Nxitja e konkurrueshmërisë së vendit**, përmes nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm social-ekonomik të rajoneve, duke ofruar:
 - Mbështetje për të siguruar rritje ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe arsimit profesional duke iu përgjigjur nevojave të tregut të punës;
 - Përmirësimi i infrastrukturës lidhëse midis dhe brenda rajoneve;
 - Zgjerim i funksioneve të zonave dhe diversifikim i ekonomive në zonat rurale dhe
 - Nxitja e përdorimit të burimeve unike social-ekonomike e kulturore të rajoneve.
2. **Rritje e kohezionit rajonal**, nëpërmjet zvogëlimit të pabarazive në shfrytëzimin e burimeve, produktivitetin dhe standardet sociale e mjedisore, nëpërmjet:
 - Përmirësimit të standardeve të infrastrukturës publike dhe rrjeteve të shërbimeve;
 - Sigurimit të mbrojtjes rajonale të integruar të mjedisit;
 - Rritjes së investimeve publike në rajonet më pak të zhvilluara.
3. **Menaxhim efektiv i zhvillimit rajonal**, nëpërmjet një qasje të re e pragmatike për zhvillimin rajonal, duke përdorur burimet e kufizuara të menaxhimit në mënyrë efikase:
 - Krijimi i mekanizmave efektive dhe efikase për menaxhimin e zhvillimit rajonal të vendit;
 - Reformimi i strukturave të lidhura me Fondin për Zhvillimin e Rajoneve si instrumenti kryesor për financimin e politikës së zhvillimit rajonal në vend;
 - Nxitjen e “partneritetit ndër-vendor” dhe “partneritetin rajonal”

Gjithashtu, SKZHI paraqet një qasje gjithëpërfshirëse për decentralizimin dhe forcimin e qeverisjes lokale, në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për vetëqeverisjen lokale dhe me parimet mbi qeverisjen lokale të sanksionuara në dokumentet administrative europiane, me qëllim sigurimin politik, decentralizimin administrativ dhe fiskal.



Reforma administrative territoriale u iniciua nga Qeveria gjatë vitit 2014. Reforma territoriale - Administrative (TAR) ka qenë në fokusin e Qeverisë së Shqipërisë, me miratimin e organizimit të ri administrativ të nivelit të parë të qeverisjes vendore në Shqipëri në 61 komuna në vend të 373 komunave ekzistuese dhe bashkive. Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020 (SKNDQV) paraqet vizionin e qeverisë Shqiptare për forcimin e demokracisë vendore dhe përparimin e procesit të decentralizimit sipas standardeve më të përparuara evropiane. Qëllimet dhe objektivat e kësaj strategjie përputhen plotësisht me qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 për zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë në rrugën e saj drejt integritimit evropian.

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2014-2020 prezanton një përjasje gjithëpërfshirëse ndaj decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetë-Qeverisjen Vendore, si edhe me parimet për qeverisjen vendore të dokumentit të Hapësirës Administrative Evropiane, me synim sigurimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal.

Strategjia Ndërsektoriale e Axhendës Dixhitale të Shqipërisë 2014-2020 e cila është në formën e draftit për konsultim dhe pritët të miratohet së shpejti. Në analogji me politikën dhe prioritetet e Bashkimit Europian, zhvillimi i TIK dhe axhenda dixhitale janë pjesë e programit të Qeverisë shqiptare 2013-2017. Programi e shikon zhvillimin e TIK dhe e-shërbimet të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit duke patur impact në zhvillimin rajonal dhe atë kombëtar. TIK është aktualisht një nga forcat kryesore lëvizëse të ekonomisë. Një e katërta e rritjes së PBB-së në BE vjen nga sektori TIK. Investimet në TIK dhe inovacion deri në 2020 pritet që të kontribuojnë në rritjen e produktivitetit në BE me 45%. Në Shqipëri, vetëm sektori i komunikimeve elektronike si pjesë e TIK jep një kontribut në GDP që llogaritet në 5-6%.

4 Mekanizmat institucional dhe instrumentat financiar për Zhvillimin e Rajoneve

I vetmi instrument, i cili adresonte praktikisht dhe pjesërisht disa nga çështjet e zhvillimit rajonal, ishte Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Gjatë viteve 2006-2009, ka funksionuar në formën e Granteve Konkurruese, për të cilat ka shërbyer si organ vendimmarrës Komiteti për Shpërndarjen e Grantit Konkurrues. Urdhri i Ministrit të Financave nr.355 date 13.01.2009, përcakton ngritjen e Komitetit për Shpërndarjen e fondeve të Grantit Konkurrues (KGK).



Ky fond, përbënte një rikonceptim të granteve konkurruese të zbatuara, me qëllim shpërndarjen e fondeve qendrore për investime kapitale tek njësitë e qeverisjes vendore, mbi baza konkurruese, çka e bënte atë më shumë të orientuar nga projektet sesa një mjet të vërtetë që adreson zhvillimin rajonal.

Në vitin 2009, në bazë të Ligjit nr. 10190, datë 26.11.2009, "Për buxhetin e shtetit 2010", Aneksi 3, ngrihet Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Ky Fond, është konceptuar si instrumenti financiar për politikën kombëtare të zhvillimit rajonal, e cila synon zhvillimin e balancuar të rajoneve/qarqeve dhe përbëhet nga grantet konkurruese për sektorët si më poshtë vijojnë:

- Infrastrukturën rrugore lokale,
- Arsimin (arsimi bazë, parauniversitar dhe arsimi universitar),
- Shëndetësinë,
- Objektet kulturore,
- Sistemin ujësjellës-kanalizime,
- Ndërtimin e tregjeve agro-ushqimore,
- Ujitjen dhe kullimin,
- Pyllëzimin.

Që prej këtij viti, Ministrinë përkatëse, sipas sektorëve të financimit, parashikojnë në programet e tyre buxhetore, vjetore dhe 3-vjeçare, fondin e dedikuar për Zhvillimin e Rajoneve.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve administrohet/menaxhohet përmes një vendimmarrje kolegjial, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, të kryesuar nga Kryeministri.

4.1 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve 2010-2013

Gjatë periudhës 2010-2012 FZHR-ja financoi projekte të ndryshme, në total prej 144 miliardë lekë. Siç jepet edhe në grafikun 1, më poshtë, peshën kryesore e zënë projektet e financuar në sektorët e infrastrukturës lokale dhe asaj të arsimit, të cilat zënë një peshë specifike në total respektivisht 43% dhe 33%, të ndjekur nga projektet në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në masën 15%.

Pesha specifike e projekteve sipas secilit sektor, ka ndryshuar nga njëri vit në tjetrin, në përputhje me prioritetet e vendosura nga autoritetet lokale, dhe në përputhje me zhvillimet specifike për vite të caktuara.




Figura 3. Peshat specifike e financimeve të projekteve sipas sektorëve nga FZHR-ja 2009-2013.

4.2 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve 2014

Për vitin 2014 Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, orientua për financimin e projekteve të reja, si dhe financimin e detyrimeve të prapambetura për projektet në vazhdim, të periudhës 2012-2013.

Përsa më sipër, fondit i alokuar specifikohet si më poshtë vijon:

- Financimi i 210 projekteve të reja, në vlerën e 7.5 mld Lekëve (75 mln USD)
- Financimi i 164 projekteve në vazhdim, në vlerën e 2.6 mld Lekëve (26 mln USD)

Me një total financimi të 374 projekteve, dhe shlyerje detyrimesh në vlerën e 10.1 mld Lekë (101 mln USD).

Sipas programeve të financimit, gjatë vitit 2014, FZHR u destinua si më poshtë vijon:

- **Programi i infrastrukturës vendore** përfaqësoi peshën më të madhe të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, duke përbërë 71% të totalit të financimit. Vlera e financimit të këtij programi, prej rreth 7.2 mld Lekë (72 mln USD) është alokuar për financimin e 166 projekteve të reja dhe projekteve në vazhdim. Përkatësisht:
 - janë financuar 119 projekte të reja, me një total financimi në vlerën 6.1 mld Lekë (61 mln USD).



- Janë financuar 47 projekte në vazhdim, me një total financimi në vlerën 1.1 mld Lekë (11 mln USD)
- **Programi i Arsimit**, në ndryshim nga vitet e mëparshme, u orientua edhe në financimin e terreneve sportive, duke i konsideruar si qendra komunitare, për njësitë e qeverisjes vendore që përfituan financim. Ky program përbën 22.1 % të totalit të financimit. Vlera financimit, prej rreth 2.2mld Lekë (22mln USD), është alokuar për financimin e 136 objekteve arsimore, terreneve sportive, si dhe projekteve në vazhdim. Përkatësisht:
 - janë financuar 64 objekte arsimore, me një total financimi në vlerën 1mld Lekë (10mln USD).
 - janë financuar 9 terrene sportive, me një total financimi, në vlerën 167mln Lekë (1.67mln USD)
 - janë financuar 63 projekte në vazhdim, me një total financimi në vlerën 1mld Lekë (10mln USD)
- **Programi i Ujësjellës-Kanalizimeve**, përbën 5% të totalit të financimit. Vlera e financimit të këtij programi, prej rreth 503mln Lekë (5mln USD) është alokuar për financimin e 59 projekteve të reja dhe në vazhdim. Përkatësisht:
 - janë financuar 10 projekte të reja, me një total financimi në vlerën 79mln Lekë (790 mijë USD).
 - Janë financuar 49 projekte në vazhdim, me një total financimi në vlerën 424mln Lekë (4.2 mln USD)
- **Programi i Pyllëzimit**, përbën 0.6% të totalit të financimit. Vlera e financimit të këtij programi, prej rreth 63mln Lekë (630mijë USD) është alokuar për financimin e 4 projekteve të reja.
- **Programi i Vadiqe-Kullimit**, përbën 0.6% të totalit të financimit. Vlera e financimit të këtij programi, prej rreth 56mln Lekë (560mijë USD) është alokuar për financimin e 5 projekteve në vazhdim, aprovuar për financim në periudhën 2012-2013.
- **Programi Art - Kulturë**, përbën 0.6% të totalit të financimit. Vlera e financimit të këtij programi, prej rreth 55.8mln Lekë (558mijë USD) është alokuar për financimin e 3 projekteve të reja.
- **Programi i Shëndetit parësor**, përbën 0.1% të totalit të financimit. Vlera e financimit të këtij programi, prej rreth 13mln Lekë (130mijë USD) është alokuar për financimin e 3 projekteve të reja.



4.3 Fondit për Zhvillimin e Rajoneve 2015

Pasi Shqipëria mori statusin kandidat, **prespektiva europiane e vendit** është edhe me e afërt. Për këtë, ka filluar procesi i përafrimit të FZHR, me politikat dhe mekanizmate Fondit European të Zhvillimit të Rajoneve (European Regional Development Fund, nën Cohesion Policy të BE), duke sjellë risi si:

- Përfshirja, për herë të parë në të e programit “Shqipëria Dixhitale”, si një nga shtyllat kryesore të FZHR, që për analogji është “baza” e dy prej “priority axis” të FEZHR të BE: inovacion dhe ICT;
- Përmirësimi i mekanizmave të menaxhimit për zhvillim rajonal, duke vendosur me instrumenta nxitës të krijimit të tyre, dy konceptet e “partneritetit ndërvendor” dhe “partneritetit rajonal”, për të stimuluar krijimin e aktorëve të zhvillimit rajonal dhe pregatitur vendin drejtë performancës së fondeve strukturore me konceptin e BE të “NUTs-regions”. Kjo mbështet edhe objektivat e politikës së reformës territoriale.
- Përfshirja e konceptit të Programeve Operacionale (sipas Rregulloreve të BE-së për FEZHR të BE/Operational Programs), për të krijuar kapacitetet dhe traditën programuese të Shqipërisë, kur ajo të jetë i përshtatshëm për Fondet Strukturore të BE-së (me negociatat) dhe të përfitojë nga financimi i FEZHR.
- Futja e konceptit të “partneritetit ndër-vendor” dhe “partneritetit rajonal” në projektet për zbatim, duke përfshirë edhe partneritetet jo vetëm midis Njësive Vendore, por edhe me partneritetet rajonale me agjencitë e zhvillimit, organizatat jofitimprurëse, si edhe subjektet private për investimet e pjesëmarrjes.
- Vendosjen e koncepteve të “Drejtimit strategjik” në menaxhimin e Fondit, bazuar në shtyllat prioritare të investimeve dhe dokumentet e Programeve dhe Nënprogrameve, për të shmangur praktikën e copëtimit të fondit, sipas nevojave të vogla dhe pa impakt (ndikim) në mbështetjen e rilindjes së qendrave tona urbane dhe rajonale.


Në mbështetje të orientimit të ri strategjik për zhvillimin e rajoneve, për vitin 2015 u fuqizua mbështetja për Programin Kombëtar “Rilindje Urbane e qyteteve të bashkëjetesës komunitare” duke akorduar për portofolin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, një fond prej rreth 100 mln USD. Destinimi i portofolit është bërë për 2 shtylla financimi përkatësisht, shtylla 1: Programet e Zhvillimit Vendor dhe Rajonal dhe shtylla 2: Shqipëria Dixhitale.

III. DIAGNOZA E KUSHTEVE SOCIALE DHE EKONOMIKE

1 Demografia dhe Tregu i Punës

Shqipëria ka një popullsi prej 2,831,741 banorë, nga kjo 1,409,931 banorë janë femra. Sipas të dhënave të tre regjistrimeve të fundit del se popullsia banuese e vendit tonë ka ardhur duke rënë: nga 3,182,417 banorë më 1989, në 3,069,275 banorë më 2001 dhe 2,800,138 banorë më 2011. Kjo do të thotë se në vitin 2011 popullsia ishte 382,279 banorë (12%) më pak se më 1989, kurse krahasuar me vitin 2001, 269,137 banorë më pak (8.8%).

Gjatë periudhës 2001-2013, në Shqipëri, popullsia banuese është reduktuar në 10 qarqe dhe ka shënuar rritje vetëm në dy qarqe (*Figura 4*). Rënia e numrit të popullsisë përgjatë kësaj periudhe në të gjithë vendin ka qenë 8.2 për qind, por në Gjirokastrë popullsia ka rënë me 35.7 për qind ndërsa në Tiranë është rritur me 26.1 për qind. Në vitin 2013, qarku me popullsinë më të vogël ka qenë Gjirokastra me afërsisht 68 mijë banorë, ndërsa qarku me popullsinë më të madhe ka qenë Tirana me 766 mijë banorë.



Burimi: INSTAT (2013)

Figura 4 Ndryshimi absolut i popullsisë në përqindje sipas qarqeve 2001 – 2013.

Treguesit e punësimit lidhen me forcën e punës, numrin e të punësuarve, numrin e të papunëve të regjistruar dhe shkallën e papunësisë.

Në Shqipëri, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, numri i të punësuarve të moshës 15-64 vjeç është 1 043 058 persona. Numri i personave të papunë të moshës 15-64 vjeç është 219 585 persona. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014 në Shqipëri për popullsinë e moshës 15-64 vjeç shkalla e papunësisë ishte 17,4 për qind. Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë është 32,4 për qind.

Popullsia në moshë pune (15-64 vjeç) zë 66.6%. Ndërkohë, popullsia me moshën 0-14 vjeç përbën rreth 20.4% të popullsisë, duke u kthyer në një potencial por edhe kosto për ndërtimin e zanateve të tyre për të ardhmen (rreth një e pesta). Ndihma ekonomike si mesatare e përqindjes së numrit të familjeve që përfitojnë është 8.34%.

Meriton adresim me përparësi:

- emigracioni bashkë me migrimin,
- braktisja e zonave rurale dhe
- integrimi i gruas në tregun e punës

2 Edukimi

Raporti neto i regjistrimeve në arsimin bazë është 85 për qind (86 për qind për djemtë dhe 84 për qind për vajzat). Gjinnazi ka numrin më të madh të të diplomuarve, meqenëse është edhe ofruesi më i madh i arsimit të mesëm. Gjatë vitit shkollor 2012-2013, në arsimin e mesëm u diplomuan 45 899 nxënës, nga të cilët pak më shumë se gjysma, 22 625 ishin femra. Të diplomuarit nga shkollat profesionale janë shumë më të paktë në numër, ndër ta janë diplomuar 4 322 nxënës, nga të cilët 1174 ishin femra. Prirjet e përgjithshme tregojnë se diplomimi nga arsimi i mesëm ka patur rritje të vazhdueshme, duke shkuar nga 31 122 nxënës gjatë vitit shkollor 2007-2008 te një numër dukshëm i shtuar me 14 777 nxënës në vitin shkollor 2012-2013. Arsimi profesional ka patur një prirje në rënie deri në vitin shkollor 2011-2012.

Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin profesional pësoi rënie gjatë periudhës 2006-2010 me rreth 30%, për të rifituar më pas ngritje graduale. Kështu, gjatë vitit shkollor 2012-2013 u vu re edhe numri më i lartë i regjistrimeve (8 996 nxënës).



Analiza ka treguar se afërsisht 35% e bashkëmoshatarëve nuk marrin ose nuk kanë marrë arsim të mesëm në Shqipëri. Në vitin 2012, pjesa e personave që e lanë shkollën më herët në Shqipëri (p.sh. të rinjtë e moshës 18-24 vjeç me të paktën arsimin e ulët dytësor), ishte afërsisht sa norma e regjistruar në BE27 (përkatësisht 31.6 për qind dhe 17 për qind). Gjithashtu, shkalla e regjistrimeve në të gjitha nivelet është ende më e ulët sesa mesatarja e regjistruar në vendet e Europës Lindore.

Sipas Anketës së Forcës së Punës 2012, shkalla e punësimit të individëve me arsim më të ulët dytësor (tetëvjeçar ose nëntëvjeçar) ishte 53.5% krahasuar me 57.4% të personave me arsim të lartë dytësor (i mesëm) dhe 66.9% për personat e diplomuar në universitet e më lart.

Të dhënat nga Anketat për Matjen e Nivelit të Jetesës 2012 tregojnë se individët me arsim më të ulët dytësor (tetëvjeçar ose nëntëvjeçar) fitojnë mesatarisht 24% më shumë se individët me arsim fillor. Personat me arsim të mesëm fitojnë rreth 22% më shumë se ata me arsim tetëvjeçar apo nëntëvjeçar, dhe arsimi të nivelit të tretë ka një shpërblim me pagë me rreth 32% më shumë se arsimi i mesëm.

Në terma të përgjithshëm, mesatarisht numri i nxënësve në shkollat 9-vjeçare për mësues është 45, ku qarku i Elbasanit mban raportin më të lartë, kurse qarku i Gjirokastrës mban raportin më të ulët, përkatësisht 55 dhe 30. Ndërsa për shkollat e mesme ky raport është 61, ku Kukësi ka raportin më të lartë (86), kurse Tirana më të ulët (42). Ka 42 shkolla të mesme profesionale në vend. Këto shkolla ofrojnë degë a profilet si në vijim: Ekonomik biznes/administrim Zyre, Gjuhë të huaja, TIK, Elektroteknikë, Mekanikë, Përpunim druri, Bujqësi, Ekonomik-Bujqësore, Hoteleri dhe Turizëm, Termohidraulikë, Mekanikë, Ndërtim, Përpunim Druri Pyjesh, Shërbime Mjete Transporti, Teknologji, Tekstile-konfeksione, Veterinari. Gjithashtu janë 9 qendra të aftësisimit profesional, ku Tirana ka 2 të tilla, kurse Berati, Dibra, Kukësi dhe Lezha nuk kanë asnjë. Janë 63,617 analfabetë nën moshën 10 vjeç ose rreth 2.7% e popullsisë së vendit.

Meriton adresim me përparësi:

- Ulja e shkallës së analfabetizmit dhe
- Zhvillimi i profesioneve (zanatet) në përputhje me nevojat e zonës dhe orientimin e zhvillimit ekonomik të zonës së zhvillimit.
- Arsimitimi dhe formimi profesional



3 Zhvillimi i shoqërisë së informacionit dhe teknologjisë

Me liberalizimin e tregut të telekomunikacioneve dhe pas privatizimit të kompanive me pronësi shtetërore, zhvillimi i infrastrukturës TIK është i lidhur ngushtë me investimet private dhe politikat nxitëse për investime private.

Konkurrenca në tregun e komunikimeve elektronike është rritur dhe në vitin 2014 operojnë në tregun e komunikimeve elektronike katër operatorë të telefonisë celulare, 79 operatorë alternativë të telefonisë fikse dhe 131 ofrues të shërbimit internet, ISP. Tre operatorë të telefonise celulare ofrojnë shërbime të lëvizshme me brez te gjerë bazuar në teknologjinë 3G.

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014 të dhënat për tregun të publikuara nga AKEP japin këto shifra: përdorues aktive të telefonisë celulare 3,473,361; numri i përdoruesve të internetit broadband nga celularët 1,058,354 ndërsa numri i pajtimtarëve fikse vazhdon të ulët duke shkuar ne 255,358 nga 281200 që ishte në fund të vitit 2013. Numri i pajtimtarëve fiks broadband 188,668.

Shkalla e përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike si telefoni celulare, Internet etj është rritur vit pas viti. Vrojtime të ndryshme tregojnë se dhe përdorimi i aparateve “smart”, tableta etj. është rritur. Përdorimi i rrjeteve sociale është në një shkallë të gjërë në vend. Gjithashtu vërehet një trend në rritje për trafikun e komunikimeve data dhe ulje të trafikut telefonik (zanor). Kjo është një tendencë globale që reflektohet dhe në vendin tonë.

Penetrimi i Internetit sipas te dhenave te publikuara nga ITU per Shqiperine vleresohet ne afer 60%, penetrimi i broadbandit dhe veçanërisht rritja në segmentin mobile broadband në nivel 37%, në fund të vitit 2013, bazuar në të gjitha llojet e pajisjeve përfshirë smartphone dhe tablete. Gjithashtu tarifat për aksesin në Internet janë ulur me disa here duke e bere me te perballueshem marrjen e ketij sherbimi. Shpejtesia e ofrimit te sherbimit internet me e perdorur eshte rritur nga 256kbit/s ne vitin 2008-2009 ne 2-4Mbit/s.

Pavarësisht progresi në fushën e TIK, Shqipëria ende mbetet larg nivelit mesatar jo vetëm të vendeve të BE, por edhe atyre të rajonit lidhur me aksesin në infrastrukturën dhe shërbimet broadband dhe kjo është e lidhur me diferencën e madhe të zhvillimit që ekziston midis rajoneve të ndryshme të vendit.

Zhvillimet për e-qeverisjen në periudhën 2008-2013 u fokusuan në nivelin qendror dhe kryesisht në shërbimet publike Qeveri – Biznes (G2B) dhe G2G. Ngritja e Qendrës Kombëtare të Liçensimit; Qendrës Kombëtare të Regjistrimit; zgjerimi i infrastrukturës GovNET (G2G), krijimi i infrastrukturës për ndërveprimin; shërbimet e-Taksa; e-



Prokurimet; e-Doganat; e-Patentat etj. janë disa nga zhvillimet kryesore. Përsa i përket e-qeverisjes në nivel vendor ka patur disa tentativa për informatizimin e shërbimeve të pushtetit vendor dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët në qendrat OSSH por nuk ekziston një zgjidhje globale e cila të mundësojë përdorimin e këtyre shërbimeve në një pjesë të mirë të pushtetit vendor si dhe të realizojë komunikimin me pushtetin qendror duke përfituar edhe nga shërbimet që ofron ky i fundit.

Strategjia SNSHI 2008-2013, ishte e fokusuar në zhvillimin e e-qeverisjes në nivel qendror. SNSHI 2008-2013 vendoste disa objektiva të përgjithshëm për e-qeverisjen në nivel vendor e shoqëruar në planin e veprimit me disa aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit për e-qeverisjen. Vrojtime periodike të kryera nga AKSHI për e-qeverisjen në pushtetin vendor tregojnë se ka bashki (si Tirana, Durresi, Korça, Elbasani, Shkodra, Lezha etj.) dhe disa komuna (si komunat e qarkut Shkodër, Lezhë) që kanë zhvilluar praktika të e-qeverisjes si për ofrimin e informacionit për shërbimet, e-pjesëmarrjes etj.

Përdorimi i TIK në këto Njësi Vendore ka gjetur hapësirë në përmirësimin e proceseve administrative, lehtësimin e qasjes ndaj informacionit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në një numër fushash të veprimtarisë së pushtetit vendor të tilla si taksat, buxhetet, planifikimi dhe menaxhimi i territorit, inspektimi, emergjencat, përfshirja e qytetarëve e bizneseve në vendimmarrje deri në modelet më të avancuara të ngritjes së Zyrave me Një Ndalesë, etj.

Ndërkohë ka një numër të madh komunash dhe bashki të vogla që mbeten ende larg përdorimit të TIK për e-qeverisjen. Pavarësisht përpjekjeve vetëm në pak raste dokumentet strategjike të QV citojnë objektiva, programe dhe projekte për e-QV (p.sh, Lezha), gjë që dëshmon për mungesën e një vizioni afatgjatë në fushën e e-Qeverisjes të QV-ve.

Duhet theksuar se zhvillimi i këtyre viteve i takon kryesisht zonave me përqendrim të lartë të popullsisë dhe sidomos kryeqytetit, ndërsa vihet re një diferencim shumë i madh i përdorimit të TIK në zonat urbane ku për shkaqe si të zhvillimit ekonomik të këtyre zonave ashtu edhe për arsye komerciale të operatorëve penetrimi i teknologjisë lë shumë për të dëshiruar.

Meriton adresim me përparësi:

Në kuadër të zbatimit të reformës administrative-territoriale dhe përshtatjes së kornizës ligjore, QV-të do të duhet të organizohen dhe funksionojnë në një mjedis administrativ dhe territorial shumë më të gjerë. Në këto kushte NJQV-të e reja do përballen me sfidën e ri-



organizimit të brendshëm dhe bashkëpunimit me Qeverinë për nivelin e integritetit në sisteme të interoperabilitetit për shërbimet e ofruara nga qeveria qendrore, që përkojnë me funksionet e deleguara apo të përbashkëta. Riorganizimi do t'i transformojë një pjesë të NJQV në njësi administrative me një ndalesë. Krijimi dhe funksionimi i një infrastrukture të integruar të Zyrrave me 1 Ndalesë (one stop shops) që ofrojnë e-shërbime për qytetarët, bizneset apo vizitorët, si dhe mundësi i bashkëveprimit me Qendrën e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) do jenë drejtimet kryesore ku do mbështet strategjia për zhvillimin e e-QV-së. Zhvillimi i unifikuar dhe i harmonizuar i e-qeverisjes si për nivelin qendror dhe atë vendor si dhe mbështetja e zhvillimit të e-qeverisjes në QV është e nevojshme për të shtrirë përfitimet nga përdorimi TIK në të gjitha shtresat dhe nivelet.

4 Ekonomia

Analiza e nivelit të PBB-së në vitet e fundit tregon se Tirana - si qendra kombëtare e rritjes ekonomike - paraqitet edhe me PBB-në më të lartë duke zënë rreth 36% të totalit të PBB-së kombëtare. Fieri dhe Durrësi - poet dytësore të rritjes - paraqiten me tregues të lartë ekonomik, megjithëse më të ulët sesa ai i Tiranës, por mjaft të lartë krahasuar me rajonet e tjera. Fieri dhe Tirana vazhdojnë të prodhojnë afërsisht gjysmën e PBB-së totale. Kukësi dhe Gjirokastra zënë peshën specifike më të ulët ekonomike duke zënë mesatarisht më pak se 3% të kontributit në PBB-së. Pavarësisht peshës specifike që secili rajon zë në totalin e PBB-së, rritja ekonomike e rajoneve në vite paraqitet e ndryshme.

Nga krahasimi i niveleve të PBB-së të vitit 2011 me ato të vitit 2008, vihet re se rajoni i Dibrës dhe i Kukësit kanë shënuar rritje më të lartë ekonomike, përkatësisht 31% dhe 28% krahasuar me vitin 2008. Në vitin 2011 qarku i Kukësit është qarku që ka pasur edhe rritjen më të madhe ekonomike me rreth 12% krahasuar me vitin 2010.




Figura 5 Tendencja e PBB-së sipas rajoneve 2007-2011



Vlera e shtuar nga është 1,031,457 mln lekë. Nga qarqet kontributin më të madh e jep Tirana me rreth 37.9% të vlerës totale, nga ana tjetër qarku i Dibrës kontribuon me masën më të vogël (3.0%). PBB për frymë (mesatarisht) është 398,752 lekë, PBB për frymë sipas vlerësimit PPS (purchasing power standards) është 10.75% të PBB për frymë në BE. Në Shqipëri ka 102,236 ndërmarrjeve aktive, ku pjesa më e madhe e tyre janë në profilin e shërbimeve dhe të tregtisë. Kredia dhënë nga bankat tregtare është 401,573 mln lekë, ku sektori që thith pjesën më të madhe të kredisë është ai i tregtisë. Industria përpunuese dhe ndërtimi vijnë pas tregtisë për nga pesha. Niveli i depozitave në bankat tregtare është 994,998 mln lekë, duke reflektuar një nivel të lartë të aftësisë kredituese nga bankat tregtare.

Madhësia mesatare e fermave është 1.2 ha, ose 5.5% e madhësinë mesatare të fermës në BE. Qarqet me nivelin më të ulët të këtij treguesi janë, sipas rendit, Kukësi, Dibra dhe Lezha. Sipërfaqe e ujitur është 204,396 ha, ndërsa prodhimi i mishit shkon në 144,816 ton. Ka marrë zhvillim të veçantë prodhimi nga ulliri, vreshti (Berat, Fier, Shkodër), molla dhe arrat (Dibër, Korçë dhe Pukë) si dhe bimët mjekësore.

Peshkimi është një industri me interes dhe rëndësi për disa zona të caktuara në Shqipëri. Ka tetë zona në bregdet që mbështesin zhvillimin në pikëpamjen tregtare të peshkimit siç është Velipoja (Shkodër), Shëngjini, Durrësi, Vlora dhe Saranda. Mjetet aktive lundruese për peshkim në total janë rreth 390, ku Durrësi mban numrin më të madh (156), ndërsa numri total i mjeteve lundruese të licencuara për peshkim është 553. Kemi numër më të madh të mjeteve të licencuara pasi numri i atyre që merren me peshkim është 70.5% e totalit të licencuar. Këto shifra i korrespondojnë vetëm peshkimit në det, por ka aktivitet peshkimi edhe në ujërat e ëmbla si për shembull në liqenin e Shkodrës (Zogaj dhe Shirok), liqenin e Pogradecit, liqenin e Ohrit (Udenisht), Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël (veç liqeneve të tjera të vogla edhe të llojit artificial). Ujërat e administruar nga shtetit nuk kanë njohur financim për mirëmbajtjen dhe rigjenerimin duke mbarështuar peshkun siç është Lin (Pogradec), Zyeza (Korçë) dhe Tapizë (Fushë-Krujë). Po ashtu, për t'u përmendur si rezervate natyrore me pasuri në botën e florës dhe të faunës janë laguna e Karavastasë, laguna e Nartës dhe liqeni i Butrintit.

Shqipëria është vend me burime minerare (Bulqiza, Kukësi, Rrësheni, Hasi etj.) dhe energjie hidrike (mbi lumin Drin, Ulza, Devolli, Bistrica etj.). Mineralet janë zë i rëndësishëm i eksporteve shqiptare. Industria e minierave ka pësuar dekadencë në vite, duke u shndërruar nga një sektor me kontribut të madh në ekonomi në një sektor me probleme të shumta.

Meriton adresim me përparësi:

- Përkrahja dhe zhvillimi i bujqësisë,
- Zhvillimi i zonave minerare;
- Shfrytëzimi i rrjetit ujor dhe,
- Nxitja e zhvillimit në atë mënyrë që të zbuten pabarazitë rajonale.

5 Industria e Turizmit dhe Kultura

Për sa i përket kulturës dhe traditës Shqipëria është, shpesh, me tipare konservatore siç janë qarqet në veri dhe ato me tipare që përqafojnë të renë dhe risitë. Konservatore në kuptimin se ruajnë elementë të trashëgimisë nga të parët (zakonet dhe sjellja). Dy janë dialektet e gjuhës shqipe, gegë dhe toskë.

Turizmi mund të jetë i tre drejtëve kryesore: për plazh (det dhe liqen); për mal dhe për atraksione kulturore (kala dhe vepra historike). Si asete natyrore janë disa, ku në veri mund të përmendet Parku Korab-Koritnik, Lura, Luzni-Bulaç, Ulza, Bjeshka e Oroshit, Korab-Koritnik, Tej Drini i Bardhë & Lugina e Valbonës, Lumi Gash, Thethi, Vermoshi, Maranai dhe Liqeni i Shkodrës.

Meriton adresim me përparësi:


- Zgjidhja e problemit të arritjes së pikave me interes turistik dhe
- Kthimi në zona të shfrytëzueshme për turizëm.
- Përfitimi ekonomik dhe social nga sektori i turizmit

6 Infrastruktura teknike për zhvillimin rajonal

Vendi zë një sipërfaqe prej 28,748 km². Sipas ndarjes së re administrative-territoriale Shqipëria ka 61 njësi vendore. Rreth 9,451 km është gjatësia e rrugëve rurale rajonale.

Shqipëria shtrihet në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit. Korridoret më të rëndësishme rrugore janë: rr. Tiranë-Kukës-Prishtinë, Tiranë-Librazhd-Maqedoni, Tiranë-Korçë-Greqi, Tiranë-Fier-Gjirokastër-Kakavijë, Tiranë-Shkodër-Podgoricë. Po ashtu, ka dalje në det me portin e Durrësit, portin e Vlorës, portin e Sarandës si dhe atë të Shëngjinit.

Ka disa pika kufitare: dy në Shkodër me Malin e Zi (Muriqan dhe Hani i Hotit), me Kosovën (Morinë, Has dhe Tropojë); me Maqedoninë me anë të pikës kufitare të Bllatës dhe të Qafë Thanës; me Greqinë në pikat Kapshticë, Kakavijë dhe Qafë Botë.



Burimi: Albania 2030 Manifesto, Një vision zhvillimi hapësinor kombëtar, Tiranë, 2014

Figura 6 Korridoret rrugore më të rëndësishme dhe lidhjet me fqinjët.

Janë miratuar nga KKRT-ja, rreth 30 instrumente të zhvillimit të territorit për të gjithë vendin. Këto instrumente ndihmojnë në integrimin e politikave të zhvillimit rajonal përfshirë edhe ato të urbanizimit. Gjithsesi, reforma administrative-territoriale që e kompozon vendin në 61 njësi e zbeh rëndësinë e këtyre planeve, sepse ka ndryshuar harta e njësive vendore.

Meriton adresim me përparësi:

- Zhvillimi i zonave rurale dhe
- Nxitja e zhvillimit të komunikimit ndër-rajonal.

7 Situata në zonat urbane dhe rurale si dhe diversiteti ndër-rajonal

Mesatarisht rreth 48.7% e të gjithë popullsisë banon në zonë urbane duke reflektuar një tregues mesatar të urbanizimit. Kjo do të thotë se pjesa më e madhe e popullsisë gjendet në zonat rurale, duke i dhënë vendit një fizionomi të zhvillimit të orientuar në aspektin rural. Pjesa e popullsisë që ka akses në sistemin e ujit është 79.8%. Ushtrojnë profesionin 3,454 mjekë dhe janë 44 spitale.

Treguesi i Zhvillimit Rajonal vlerësuar për vitin 2010 dhe 2012 për qarqet ka nxjerrë në pah se pabarazitë mes qarqeve janë prezent dhe se këto pabarazi nuk janë zbehur në harkun e viteve 2008-2012. Treguesi i Zhvillimit Rajonal është një indikator i konceptuar dhe ndërtuar për të matur pabarazitë mes qarqeve (rajoneve); për të ndihmuar dhe orientuar politikën e zhvillimit në qarqe dhe sektorë të caktuar; si dhe për të matur impaktin e financimeve të realizuara. Ky tregues kompozohet nga 18 variabla të ndryshëm duke u grupuar në katër klasa: (i) PBB për frymë; (ii) tregues bazë; (iii) përforcuesit e eficiencës dhe (iv) faktorët e inovacionit. RDI mesatar i qarqeve arrin nivelin 87, maksimal 146 (Tirana) dhe minimal 69 (Dibra). Diferenca max-min është 77, duke reflektuar një pabarazi shumë të madhe të zhvillimit rajonal në Shqipëri. Më me rëndësi është të theksojmë se vlerësimet e këtij treguesi për vitin 2008 dhe 2012 na sugjerojnë se politikën e zhvillimit në vitet e kaluara nuk kanë arritur të adresojnë në mënyrën e duhur problematikën e zhvillimit të pabarabartë të rajoneve. Politikën e zhvillimit në të ardhmen duhet të hartohen dhe zbatohen duke pasur parasysh këtë.




Figura 7 Treguesi i Zhvillimit Rajonal sipas qarqeve për vitin 2012.

Meriton adresim me përparësi:

- Lufta për zbutjen e varfërisë,
- Zbutja e pabarazive rajonale,
- Promovimi dhe forcimi i ekonomive lokale
- Krijimi i identiteteve lokale dhe rajonale

8 Shërbimet Publike

Shërbimet publike, për të cilat mund të orientohet Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, kryesisht kanë të bëjnë me furnizimin me ujë dhe kanalizimet, transportin ndërqytetas, infrastruktura rrugore dhe rehabilitimi i shesheve publike, terminaleve multimodale, etj.

Si shërbime të pazhvilluara dhe për të cilat ka nevojë për ndërhyrje thelbësore në menaxhim dhe fuqizim janë strukturat ndërlidhëse dhe terminallet multi-modale të transportit. Në të gjitha qendër qarqet, ka nevojë për ndërtim të terminaleve multimodale, për transportin qytetas, ndërqytetas, dhe në disa raste edhe lidhja me hekurudhën.

**Meriton adresim me përparësi:**

- Hartimi i planeve/masterplaneve të shërbimit të transportit dhe,
- Ndërtimi i terminaleve.

9 Mjedisi dhe Infrastruktura për mbrojtjen e mjedisit

Shqipëria ka potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e një turizmi që siguron zhvillim ekonomik af-atgjatë dhe prosperitet social e mjedisor. Shqipëria sot konsiderohet një nga 10 ekonomitë me rritje më të shpejtë të turizmit krahasuar me GDP-në. Vendi ka 450 km bregdet, nga të cilat 300 km në detin Adriatik, dhe 150 km në detin Jonian. Aty gjenden rreth 24 zona potenciale, shumica ende të virgjëra, për zhvillim cilësor turizmi. Ndërkohë më shumë se gjysma e sipërfaqes së vendit janë zona malore me mbi 600 m mbi nivelin e detit, dhe aty ndodhen edhe 15 zona të tjera që kanë gjithashtu potencial për zhvillimin e turizmit.

Përveç potencialit të zonave turistike detare, Shqipëria ka mjaft potenciale të tjera në brendësi të vendit, përfshi: (i) Tre liqene (Shkodër, Ohër dhe Prespë), një rrjet liqenesh të vegjël (Dumre, Lurë, etj) dhe dhjetra liqene artificiale. Vendi ka 15 parqe kombëtare, zona të ndjeshme ekologjike-em-eralde, dhe zona të tjera pyjore kudo. (ii) Ekziston një trashëgimi e pasur arkeologjike e periudhave Ilire, Romake, Helene, Bizantine, Veneciane, Otomane, etj, përfshi: Butrintin (UNESCO), Apolloninë, Bylis dhe Durrësin. Ka edhe mjaft manastire, kisha dhe kështjella e fortifikime mesjetare. Vendi ka dy qytete muze: Beratin dhe Gjirokastrën (UNESCO), dhe mjaft të tjera me cilesi të veçanta arkitektonike. (iii) Kultura shqiptare ka larmi besimesh fetare, folklori, traditash dhe kostumesh popullore; shumëllojshmëri punimesh artizanale e kulinarie; njerëzit janë miqësorë e mikpritës me të huajt dhe përgjithësisht njohin gjuhët e huaja. Klima është e mirë me diell dhe me një sezon relativisht të gjatë veror.

Megjithë këto potenciale, ajo që ka munguar është sensibilizimi i popullsisë, ngritja e kapaciteteve vendore publike e private, dhe mungesa e vizionit dhe politikave në shkallë kombëtare.¹

¹ Albania 2030 Manifesto, Një vision zhvillimi hapësinor kombëtar, Tiranë, 2014



Asetet natyrore të zotëruara nga Shqipëria kanë nevojë (pjesa më e madhe e tyre) për rehabilitim dhe për kthimin e tyre në destinacione të arritshëm. Për shembull, Parku i Lurës aktualisht është i dëmtuar dhe ka nevojë për pyllëzim dhe përkujdesje si për territorin ashtu edhe për liqenet. Më tej, për të arritur në Majën e Jezercës, pikë me rëndësi turistike me karakter alpin, për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore vizitori zgjedh itinerarin Tiranë-Kukës-Gjakovë-Tropojë. Po ashtu, Vermoshi dhe Thethi janë pika të vështira për tu arritur. Zonat e bregdetit janë më mirë me treguesin e aksesimit me transport. Në këtë pikë, FZHR ka luajtur një rol në konvergjencë me politikat e Ministrisë së Mjedisit, duke financuar projektet për pyllëzim të zonave të caktuara (si për shembull, në Sarandë), projekte këto me rëndësi për mbrojtjen dhe rigjenerimin e mjedisit.

Meriton adresim me përparësi:

- Rehabilitim i pikave me interes mjedisor dhe
- Mbrojtja dhe zhvillimi i tyre.

10 Bashkëpunimi ndër-vendor

Ka shumë qarqe që mund të konsiderohet si shembull suksesi i bashkëpunimit ndër-vendor, pasi janë bërë pjesë e disa projekteve të financuar nga burime të jashtme (donator dhe grante). Gjatë vitit 2013-2014 janë nisur dhe zhvilluar 9 projekte, ku financime nga IPA, Zvicra dhe Gjermania/KFË, Holanda dhe Italia kanë financuar skema bashkëpunimi rajonal dhe ndër-rajonal, kryesisht në fushën e mjedisit, bujqësisë dhe turizmit.

Përvoja në këto bashkëpunime, jep shenja pozitive për synimet e politikës së ardhme për zhvillimin e rajoneve, për krijimin e partneriteteve dhe rrjetëzimeve rajonale dhe ndër-rajonale. Ndër qarqet me fare apo aspak eksperiencë bashkëpunimi rajonal, përmendim qarkun e Kukësit dhe Dibës.

Meriton adresim me përparësi:

- Nxitja e bashkëpunimit ndër-vendor.
- Promovimi i skemave të partneritetit rajonal dhe ndërkufitare
- Krijimi dhe forcimi i rrjetëzimeve rajonale, ndër-rajonale dhe ndërkufitare

11 Migracioni i brendshëm

Përpara ndryshimit të regjimit, të gjitha llojet e lëvizjeve migratore në Shqipëri ishin të rregulluara në mënyrë rigoroze e të kufizuara, përfshi migracionin brenda vendit. Me kalimin në një ekonomi të hapur tregu, lëvizja e brendshme në vitet '90 u rrit në mënyrë dramatike. Kjo rritje e lëvizjes i atribuohet përgjithësisht kërkesës së papërmbushur për një lëvizje të lirë dhe Shqipëria u kthye në kuptimin e plotë në një 'vend në lëvizje', qoftë sa i takon migracionit të brendshëm, ashtu edhe atij ndërkombëtar.

Ashtu si në vende të tjera në tranzicion, edhe në Shqipëri të dyja dukuritë janë të lidhura ngushtë. Intensiteti, drejtimi dhe arsyet që çojnë drejt këtyre lëvizjeve ndikohen nga zhvillimet ekonomike, politike e shoqërore që kanë ndodhur me kalimin e kohës në Shqipëri. Dinamika e lëvizshmërisë nënkuptonte se Shqipëria u bë e njohur për emigracionin e saj në nivel ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë, pavarësisht se ka qenë një nga proceset më të rëndësishme në Shqipërinë pas komunizmit, lëvizja e brendshme mbetet gjerësisht e padokumentuar dhe sigurisht, e pastudiuar.

Migracioni ka qenë një prej tipareve më dinamike të tranzicionit të vendit dhe një prej dukurive më të rëndësishme shoqërore dhe ekonomike. Edhe pse lëvizjet e brendshme janë shumëdimensionale, është e dukshme se shumica dërrmuese e flukseve të migracionit të brendshëm është përqendruar drejt Tiranës. Në fakt, janë kryesisht zonat përreth qytetit të Tiranës ato që tërheqin pjesën më të madhe të migrantëve të brendshëm. Përgjithësisht, mund të vihet re se flukset migratore drejt një qyteti të caktuar, qoftë ky Tirana ose Durrësi, devijojnë në destinacionet pranë.

12 Zhvillimi social dhe niveli varfërisë

Rritja e qëndrueshme ekonomike deri në vitin 2008 ndikoi në uljen e varfërisë (nga 25.4 për qind në vitin 2002 te 12.4 për qind në vitin 2008), veçanërisht në zonat rurale. Gjatë periudhës 2008-2012 ngadalësimi i aktivitetit ekonomik dhe gjendja e përkeqësuar e tregut të punës e rritën nivelin e varfërisë (në 14.3 për qind) dhe veçanërisht në zonat urbane.

Ndërkohë që pjesa e popullsisë urbane, e cila jetonte në varfëri ra me rreth 12 për qind midis viteve 2008 dhe 2012, pjesa e të varfërve në zonat urbane u rrit me rreth 37 për qind. Rritje të tilla të varfërisë në zonat urbane, krahasuar me zonat rurale, ndodhin për shkak të lëvizjes së vazhdueshme të popullsisë nga zonat rurale në ato urbane. Të dhënat e disponueshme tregojnë se grupet e popullsisë që përballen me rrezikun e lartë të varfërisë janë të papunët,



më pak të arsimuarit, pjesëtarët e familjeve të mëdha, personat që jetojnë në zona rurale dhe ata që janë të punësuar në ferma për llogari të tyre.

Varfëria sipas vijës kombëtare është, si mesatare e qarqeve, 14.5% (pjesa e popullsisë që jeton me më pak se një sasi të caktuar të ardhurash në ditë), thellësia (apo hendeku tregon mesatarisht sa i varfër është një person që jeton nën vijën e varfërisë) 3.0%, ashpërsia (sa është pabarazia mes të varfërve dhe lidhet me tendencën që ka një i varfër për tu bërë edhe më i varfër) 1.0%, koeficienti Gini që shpreh pabarazinë në të ardhurat neto mes të pasurit dhe të varfrit është 25.9%, kurse vdekshmëria foshnjore është 8.4 për 1000 lindje.

Krahasimet midis të varfërve të zënë me punë dhe jo të varfërve nxjerrin në pah ndryshime të qarta, të cilat mund të ndikojnë pozicionin dhe cënueshmërinë e tyre në tregun e punës. Pjesa e të varfërve të zënë me punë përbën rreth 59% krahasuar me shifrën prej rreth 78% për jo të varfrit. Përveç kësaj, brenda vetë grupit të të varfërve të zënë me punë, rreth 76% e tyre janë në punësim me pagë, krahasuar me afërsisht 85% të grupit të jo të varfërve. Një ndryshim tjetër ka të bëjë edhe me arsimin e tyre, i cili përbën një faktor të rëndësishëm në tregun e punës.

Tabela 1 Ndryshimet midis të varfërve absolutë dhe jo të varfërve

Ndryshoret	Të varfrit e zënë në punë	Jo të varfrit të zënë në punë	Gjithsej
KARAKTERISTIKAT INDIVIDUALE			
Paga mujore (Lekë të vjetra)	285292	333676	328741.90
Sigurimet shoqërore	43.90%	71.74%	68.90%
Eksperiencia e punës	24.41	24.62	24.60
Arsimi	9.62	11.52	11.33
PËRBËRJA E FAMILJES			
Madhësia e familjes	6.10	4.68	4.83
Numri mesatar i meshkujve në moshë pune në familje	1.58	1.44	1.45
Numri mesatar i femrave në moshë pune në familje	1.35	1.30	1.31
Numri i fëmijëve 0 deri 5 vjeç	0.65	0.32	0.36
RAJONET			
Bregdetare	43.22%	30.86%	32.12%
Qendrore	29.73%	40.65%	39.54%
Malore	3.72%	5.49%	5.31%
Tiranë	23.32%	22.99%	23.03%
Urbane	61.32%	60.60%	60.67%
Rurale	38.68%	39.40%	39.33%

Niveli arsimor i sinjalizon punëdhënësit mbi produktivitetin e mundshëm të personave që punësojnë. Një nivel më i lartë arsimor shoqërohet me mundësi më të shumta për gjetjen e punësimit, si edhe me shpërblime më të mira në tregun e punës. Zakonisht, mungesa e arsimimit shoqërohet me vende pune, ku kërkohen aftësi të pakta, të cilat ofrojnë paga më të ulëta, si edhe siguri më të ulët në atë vend pune. Si rrjedhim, personat më pak të arsimuar janë më të rrezikuar nga përjashtimi prej tregut të punës. Cenimi i këtyre individëve rritet edhe më shumë, kur mungesa e arsimimit shoqërohet me varfërinë absolute. Figura 8 tregon që të varfrit e zënë me punë kanë më pak vite arsimimi sesa jo të varfrit të zënë me punë. Mesatarisht, të varfrit e zënë me punë kanë rreth 9.6 vite arsimim krahasuar me 11.5 vite për jo të varfrit.




Figura 8 Pjesëmarrja në profesione.

Të varfrit e zënë me punë janë të përqendruar kryesisht në profesione që kërkojnë aftësi të pakta dhe të cilat ofrojnë më pak siguri për vendin e punës. Krahasuar me jo të varfrit e zënë me punë, gati gjysma e profesioneve janë si punëtorë në bujqësi (rreth 22%) dhe si profesione fillestare (rreth 20%). Ky grup pothuajse nuk ekziston në radhët e ligjvënësve dhe profesionistëve. Pjesa tjetër e profesioneve janë kryesisht të përqendruara tek punëtorët në zanate dhe tregti, punëtorët e shërbimeve dhe operatorët e impianteve dhe makinerive.



IV. VIZIONI, QELLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIK

Vizioni për zhvillimin e rajoneve të Shqipërisë për 2014-2020 lidhet me krijimin e një ekonomie të qëndrueshme, konkurruese rajonale me orientim dinamik të jashtëm dhe kohezion të brendshme ekonomik, social, gjeografik dhe administrativ.

Për periudhën 2015-2016, vizioni për zhvillimin e rajoneve fokusohet në:

“Rilindjen urbane e qyteteve të bashkëjetesës komunitare”

Qëllimi Strategjik konsiston në rritjen e aftësisë konkurruese, orientimit të jashtëm të ekonomisë duke përmirësuar kohezionin e brendshëm rajonal dhe social dhe adoptimin e modeleve të qëndrueshme për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe menaxhimit të mjedisit. Kjo do të arrihet duke shfrytëzuar në mënyrë dinamike avantazhet dhe potencialet e rajonit në një mjedis të ri, në të cilin investimet në aksesibilitet, cilësi, dije, inovacion, partneritete dhe rrjete do të luajnë një rol në zgjimin e ekonomive lokale dhe fuqizimin e identiteteve rajonale. Qendrat urbane do të jenë shtyllat dinamike të zhvillimit, që do të mbështesin të tërë përpjekjet e zhvillimit rajonal.

Objektivat e Përgjithshme:

- Përmirësimi i aksesit përmes ndërtimit dhe përmirësimit të infrastrukturës, si dhe rrjeteve ndër-rajonale dhe ndër-rajonale të transportit,
- Menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit natyror dhe atij të ndërtuar, si dhe burimeve natyrore,
- Forcimi i ekonomisë ndër-rajonale dhe kohezionit social,
- Rritja e bashkëpunimit ndër-rajonat dhe krijimi i identiteteve rajonale,
- Përfitimi nga turizmi dhe trashëgimia kulturore për një zhvillim të qëndrueshëm,
- Përmirësimi i cilësisë dhe fuqizimi inovativ i shërbimeve, strukturave dhe sipërmarrjes, konkurrencës dhe orientimit të jashtëm,
- Promovimi i konvergencës dixhitale dhe
- Zhvillimi i burimeve njetëzore.

V. AKSET PRIORITARE TË PROGRAMIT OPERACIONAL

Programi Operacional përfshin 5 Akse Prioritare, që kanë të bëjnë me ndërhyrje në infrastrukturë dhe akses në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm dhe cilësinë e jetës, konvergencën digjitale dhe inovacionin, kohezionin dhe ndërveprimin rajonal si dhe mbështetje teknike për zbatimin e këtij programi. Mund të aplikohen të gjitha apo disa akse prioritare për secilën Zonë Zhvillimi.

Aksi Prioritar 1. Zhvillimi i infrastrukturës rajonale të aksesit

Qëllimi i përgjithshëm është përmirësimi i aksesit në infrastrukturë dhe shërbime për të promovuar kohezionin rajonal, për të siguruar qarkullimin e sigurt të mallrave, shërbimeve dhe njerëzve në zonën e zhvillimit, dhe në të gjithë vendin, krijimin e një ekonomie konkurruese dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Në mënyrë të veçantë, krijimi i infrastrukturës moderne të transportit në të gjitha nivelet, përmirësimi i mëtejshëm i aksesit dhe shërbimeve të atij rajoni, duke e konsideruar si një qendër të rëndësishme investimesh si dhe një zonë me cilësi të lartë, jetese. Do të arrihet shpërndarja e barabartë e burimeve ekonomike, përmirësimi gradual i pabarazive të brendshme rajonale e ndër-rajonale dhe zbutja e divergencave mes rajoneve më të zhvilluara dhe atyre më pak zhvilluar. Gjithashtu ky prioritet do të synojë përgatitjen e projekteve infrastrukturore me dimension rajonal, të një rëndësie ndër-rajonale e kombëtare.

Programi 1. Infrastruktura Vendore dhe Rajonale

- Masa 1: Përmirësimi i aksesit dhe lëvizjes (projekte me impakt rajonal dhe ndër-rajonale)
- Masa 2: Rivitalizimi i poleve urbane dhe qendrave rajonale (Rilindja Urbane e qyteteve, poleve të zhvillimit dhe qendër qarqeve)
- Masa 3: Plane të integruara zhvillimore, rajonale dhe ndër-rajonale.

**Aksi Prioritar 2. Kohezioni dhe Bashkëpunimi Rajonal**

Qëllimi i përgjithshëm është promovimi i bashkëpunimit dhe partneriteteve, për të siguruar kohezionin rajonal dhe rritjen e aftësive konkurruese, për të nxitur zhvillimin e zonës së zhvillimit dhe transformimin e tij në një pol të zhvillimit të qëndrueshëm. Ndërhyrjet do të jenë kryesisht në forcimin e infrastrukturës së nevojshme mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit natyror; plotësimin dhe përmirësimin e transportit bazë dhe infrastrukturës lidhëse, si terminallet e autobusëve, urat, rrugët etj.; promovimin e burimeve kulturore dhe ndërlidhja e tyre me aktivitetet e turizmit; përmirësimin e menaxhimit të furnizimit me ujë dhe të shpërndarjes; zbatimin e veprimeve të veçanta për balancimin e kostove shtesë të gjeneruara nga madhësia e vogël e tregut, vështirësitë e qasjes dhe shpërndarjes gjeografike; përmirësimi i infrastrukturës arsimore, shëndetësore dhe sociale si dhe mirëqenies.

Programi 1. Infrastruktura Vendore dhe Rajonale

- Masa 1. Përmirësimi i infrastrukturës dhe promovimi i atraksioneve zhvillimore (infrastrukturë rrugore me interes të veçantë zhvillimi)
- Masa 2. Përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës ndërlidhëse vendore, rajonale dhe ndër-rajonale (terminal autobusësh, ura etj.)
- Masa 3. Rehabilitim i mjediseve kulturore-artistike, të ndërtuara (që shërbejnë si destinacione kulturore rajonale dhe kombëtare).

Programi 2. Rehabilitim Mjedisor

- Masa 1. Pasurimi dhe gjallërimi i parqeve rajonale, ndërkufitare.

Programi 3. Arsimi dhe Sporti

- Masa 1. Edukim dhe arsimim cilësor, trajnim dhe formim profesional (shkollat profesionale),
- Masa 2. Riaktivizim i stadioneve sportive me qëllim zhvillimin e aftësive.

Programi 4. Furnizimi me ujë dhe sistemi i kanalizimeve

- Masa 1. Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë, në funksion të zhvillimit të zonave me interes turistik, zonave të mbrojtura, zonave të shërbimit më shumë se 1 rajona, etj.)



- Masa 2. Përmirësimi i sistemit të shpërndarjes, në funksion të zonave të zhvillimit (zonat me interes turistik, zona të mbrojtura, zona shërbimi më shumë se 1 rajona, etj.)

Aksi Prioritar 3. Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Cilësia e Jetës

Qëllimi i përgjithshëm është mbrojtja e mjedisit natyror dhe atij të ndërtuar, si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës të atyre që jetojnë në atë zonë zhvillimi, në të mirë të rritjes së qëndrueshme. Në këtë kuadër, i shërben qëllimeve natyrale të rritjes së rajonit, të cilat ende nuk janë zhvilluar. Për më tepër, synon zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm.

Programi 1. Infrastruktura Vendore dhe Rajonale

- Masa 1. Përmirësimi i infrastrukturës vendore/lokale dhe ndër-vendore;
- Masa 2. Rehabilitimi i fasadave dhe objekteve më rëndësi të veçantë historike, ekonomike.

Programi 2. Rehabilitim Mjedisor

- Masa 1. Gjelbërimi i akseve rrugore dhe shesheve urbane dhe
- Masa 2. Rehabilitimi i zonave të degraduara mjedisore.

Programi 3. Arsimi

- Masa 1. Përmirësimi i cilësisë së arsimit bazë (rehabilitim, ndërtim shkollash),
- Masa 2. Përmirësimi i cilësisë së arsimit mesëm (rehabilitim, ndërtim shkollash),
- Masa 3. Përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë
- Masa 4. Shkolla - Qendër komunitare (terrene sportive)

Programi 4. Shëndetësia

- Masa 1. Përmirësimi i shërbimit parësor shëndetësor.

Programi 5. Furnizimi me ujë dhe sistemi i kanalizimeve

- Masa 1. Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve dhe
- Masa 2. Furnizimi me ujë, si arredim urban (çezmat publike).

**Programi 6. Art-Kulturë**

- Masa 1. Ndërtimi i qendrave multifunkionale, dhe
- Masa 2. Rehabilitim dhe mirëmbajtje e objekteve me interes kulturor dhe artistik.

**Aksi Prioritar 4. Teknologjia Informative e Komunikuese (TIK)
ose Konvergenca Dixhitale**

Qëllimi i përgjithshëm i TIK është promovimi i inovacionit dhe teknologjisë, integrimin e tyre në strukturën e shërbimeve si një mënyrë e përhershme zhvillimi dhe rinovimi të motorëve të operimit. Kjo përmes futjes në një shkallë më të gjerë dhe përdorimit më të mirë të Teknologjisë Informative dhe Komunikuese (TIK) nga ana e qytetarëve, qeverive dhe bizneseve/aktiviteteve ekonomike, për krijimin e një kulture inovacioni, të aftë për të përshtatur risitë e krijuara me nevojat e rajonit. Mbështet realizimin e Agjendës digjitale për Shqipërinë, për të maksimizuar potencialin social dhe ekonomik të TIK, për një ekonomi dixhitale të zhvilluar. Qasja do të bazohet në shfrytëzimin e inovacionit, në përgjigje të kërkesave në rritje të shoqërisë, dhe uljen e pabarazive në përdorimin dhe përfitimet e TIK në të gjithë rajonet dhe zonat e zhvillimit. Do të fokusohet në krijimin e kushteve për zhvillimin e biznesit dhe përdorimin e TIK në fusha me interes publik, të tilla si shëndetësia, edukimi, përfshirja sociale dhe administrata publike.

Programi 1 : E-Shërbimet dhe shërbimet elektronike

- Masa 1. Shërbime online për publikun në front-office e përqëndruar si dhe Transparenca online me publikun.
- Masa 2. Platformat për shërbimet publike të pushtetit vendor.
- Masa 3. Dixhitalizimi i shërbimeve të lidhura me pronësinë e tokës për rajone të caktuara ose të përqëndruara.
- Masa 4. Shërbimet e Infrastrukturës TIK (HW + SW) të cilat janë bazë për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut që kanë të bëjnë me :
 1. Konsolidimi i të dhënave bazë të shtetasve : Implementimi i Sistemit të adresave dixhitale mbi bazën e fotos ajrore 2015 dhe lidhja e sistemit të adresave me regjistrin e gjendjes civile.
 2. Konsolidimi i infrastruktures së përbashkët ndërinstitucionale në nivel rajonal dhe kombëtar (rrjete, ndërlidhje sistemesh, lidhja e sistemeve në platformën qeveritare të ndërveprimit, datacenter, BCC, DRC, qarkullimi elektronik i



dokumentave, gjurmimi i korrespondencës së qytetarëve me administratën e të gjitha niveleve etj.)

3. Infrastruktura në shërbim të rendit dhe sigurisë si dhe të shërbimeve në sportel dhe online të policisë së shtetit.
4. Infrastruktura në shërbim të kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve në sportel të sistemit shëndetësor në nivel rajonal dhe kombëtar.
5. Konsolidimin e të dhënave shtetërore të arkivave me krijimin dhe plotësimin e regjistrave elektronikë dhe shërbimeve elektronike.
6. Ngritja e platformave dixhitale të përqendruara apo rajonale në shërbim të bujqësisë dhe turizmit.

Programi 2 : Përmirësimi i jetës së qytetarëve nëpërmjet zhvillimit teknologjik të qyteteve dhe rajoneve.

Smart qytetet përfshijnë investimet për projekte të cilat do të krijojnë apo përmirësojnë sisteme të TIK për lehtësimin e jetës dhe veprimtarisë së qytetareve. Duhet theksuar që investimet në këtë nënprogram nuk janë të lidhura vetëm me zhvillimet rajonale por edhe me zhvillimet në rang kombëtar ku përfituesit finalë janë pushteti vendor, qytetarët dhe biznesi.

- Masa 1. Replikimi i sistemeve të suksesshme ekzistuese shumëpërdoruesish (shkolla, Bashkia, Policia, DAR, Prokuroria): monitorim me kamera të rrugëve, kryqëzimeve, shkollave dhe objekteve të tjera të rëndësishme.
- Masa 2. Përmirësimi i infrastrukturës vendore në shërbim të zhvillimit të aksesit ndaj shërbimeve broadband dhe atyre dixhitale.
- Masa 3. Programe e-biblioteka për të mundësuar përdorimin e burimeve të cdo biblioteke rajonale dhe vendore në rang kombëtar.
- Masa 4. Programe në mbështetje të fëmijëve në sistemin parashkollor dhe atë shkollor.
- Masa 5. Sisteme informatike për menaxhimin e trafikut urban dhe ndërrurban në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj publikut.
- Masa 6. Platforma OSS ose online për shërbimet që ofron pushteti vendor.
- Masa 7. Platformat mobile në funksion të shërbimeve të informacionit turistik, ekonomik , kulturor , arsimor në nivel rajonal dhe kombëtar.



- Masa 8. Furnizimi i shtetasve në nevojë me dekodera universal në kuadrin e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike .

Aksi Prioritar 5. Asistencë Teknike

Qëllimi i përgjithshëm është ofrimi i mbështetjes për shpërndarjen në kohë të projekteve, i asistencës për përfituesit në përgatitjen, zbatimin, monitorimin, kontrollin, vlerësimin si dhe njohjen e mundësive të bashkëfinancimit, për projektet rajonale, ndër-rajonale dhe ndër-rajonale.

- Masa 1. Asistencë për përgatitjen e projekteve pipeline (me tuba),
- Masa 2. Mbështetje sekretariateve teknike, për masat e kontrollit dhe auditimit të projekteve të financuara
- Masa 3. Ofrimi i sesioneve trajnuese për ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve aplikuese dhe atyre vlerësuese, monitoruese dhe raportuese.

VI. FINANCIMI

1 Financimi i Brendshëm

Për vitin 2015, Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR), i është akorduar nga buxheti i shtetit një portofol në vlerën e 100 milion USD (12,189 mld Lekë). Programi për këtë vit, përbën 18% të totalit të shpenzimeve kapitale të buxhetit të shtetit ose 41% të shpenzimeve kapitale të brendshme. Në këtë fond nuk janë përfshirë Programet buxhetore të Ministrive dhe produktet/projektet që financohen nga këto programe.

Për vitin buxhetor 2015, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është planifikuar në shtylla kryesore financimit, specifikuar si më poshtë vijojnë:

- A. **Shtylla I: Programet e Zhvillimit Vendor dhe Rajonal:** që përbëhet nga grantet për:
- a) infrastrukturën vendore dhe rajonale me 97,5 mln USD
 - b) arsimin dhe sportin: (arsimin bazë; arsimin e mesëm; arsimin universitar; sportin)
 - c) shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor);
 - d) artin dhe kulturën;
 - e) ujësjellës-kanalizime;
 - f) vaditje dhe kullim dhe
 - g) rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzimin.
- B. **Shtylla II: Programi “Shqipëria Dixhitale”**
- a) inovacioni dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit), me fond në total prej 25 mln USD.

2 Financime plotësuese

Financimet plotësuese mund të vijnë nga programet buxhetore të ministrive, jashtë Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, projekte të donatorëve me fokus zhvillimin e rajoneve (ekonomik, social apo mjedisor), si dhe bashkëfinancime në formë granti, nga donatorë të ndryshëm.

VII. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Ky seksion përshkruan kornizën institucionale për zbatimin dhe monitorimin e Programit Operacional 2015-2016, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Aneksin 3, të Ligjit Nr.160, datë 2015/11/27 “Për buxhetin e vitit 2015”.

1 Strukturat e përfshira dhe kompetencat përkatëse

Në funksion të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve dhe bazuar në kuadrin ligjor përkatës, janë ngritur strukturat si më poshtë vijojnë:

- Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i kryesuar nga Kryeministri, ka në përbërjen e tij ministrinë përkatëse të linjës, shoqatën e bashkive të Shqipërisë, shoqatën e komunave të Shqipërisë, shoqatën e qarqeve të Shqipërisë dhe shoqatën e autonomisë vendore.
- Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është pranë Kryeministrit, si pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj.
- Sekretariatet teknike, pranë ministrive përkatëse të linjës respektivisht në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

1.1 Autoriteti i menaxhimit të fondit dhe miratimit të financimit

Komiteti është struktura institucionale e cila kryen shpërndarjen e financimit dhe menaxhimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve. Komiteti luan rolin e organit koordinues, qendror për kuadrin e zhvillimit strategjik rajonal, të vendit.

Ky komitet siguron koherencën strategjike të politikave rajonale dhe kombëtare, menaxhimin e fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit, si dhe fondeve plotësuese nga



burime të tjera financimi, me synim përmbushjen e objektivave të zhvillimit rajonal e kombëtar.

1.2 Autoriteti i menaxhimit të procesit të programimit

Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, si pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, kryen funksionet si më poshtë vijojnë:

- harton kriteret e vlerësimit tekniko-financiar dhe strategjik të përzgjedhjes së projekteve, në bashkëpunim me sekretariatet teknike,
- analizon projekt-propozimet, në lidhje me përputhjen e tyre me prioritetet strategjike kombëtare, dhe programit politik të qeverisë.
- siguron programimin e mbledhjeve të Komitetit dhe përgatit kalendarin vjetor të mbledhjeve
- përgatit propozimet teknike, draft vendimet, dhe dosjet e materialeve për diskutim, në lidhje me shpërndarjen e fondeve nga Komiteti;
- Bën zbardhjen e vendimit dhe komunikon me Ministrinë e Financave për vijimin e procedurës së çeljes së fondeve, sipas vendimit(eve) të Komitetit.

1.3 Autoritetet e ndërmjetme vendimmarrëse

Sekretariatet teknike, të ngritura në ministritë përkatëse të linjës, (me urdhër të posacëm të ministrit përkatës), kryejnë funksionet si më poshtë vijojnë:

- kryejnë vlerësimin tekniko-financiar për projektet e paraqitura nga aplikuesit, sipas kriterëve të miratuara paraprakisht, nga Komiteti. Vlerësimi kryhet, në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të projekteve, të hartuar sipas programeve respektive të aplikimit.
- bëjnë njoftimin zyrtar të autoriteve kontraktuese të projekteve, të shpalluara si fituese për financim.
- monitorojnë respektimin e procedurave të prokurimit nga autoritetet kontraktuese dhe ndjekin ecurinë e zbatimit të projekteve.
- përgatisin raportime periodike dhe vjetore mbi performancën e financimit të projekteve, dhe të menaxhimit të fondit në tërësi.

1.4 Autoritetet aplikuese

Autoritetet aplikuese, të konsideruara autoritete kontraktuese mund të jenë njësi të qeverisjes lokale, qarqet, agjenci zhvillimore, ujësjellës sh.a, institucione të edukimit të lartë, organizata kërkimore, borde lokale/rajonale të turizmit, etj.

2 Shpallja, vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve për financim

Fazat kryesore nëpër të cilën kalon procesi i financimit të projekteve janë shpallja e thirrjes për financim, vlerësimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e projekteve, si dhe miratimi i financimit të projekteve fituese.

A. Shpallja e thirrjes për financim

Shpallja e thirrjes për projekt-propozimet, bëhet me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Në Vendim bëhen të ditura akset prioritare, programet dhe fushat që do të mbështeten me financim. Pjesë e shpalljes së thirrjes janë formulari i aplikimit dhe kriteret e vlerësimit tekniko-financiar dhe strategjik.

B. Vlerësimi i projekteve të aplikuara dhe përzgjedhja e projekteve fituese

Sekretariati i Përgjithshëm zhvillon kriteret kryesore të përshtatshmërisë dhe përzgjedhjes së projekteve, në konsultim me ministritë përkatëse, dhe ia paraqet për miratim në KZHR. Sekretariati garanton transparencën, objektivitetin dhe eficiencën e procedurës së përzgjedhjes, e si rrjedhojë edhe cilësinë e projekteve.

Sekretariatet teknike kanë përgjegjësinë për përzgjedhjen e projekteve fituese, nga të gjitha aplikimet e bëra, në përputhje me kriteret e specifikuar më parë.

Komiteti miraton shpërndarjen e financimit për projektet e përzgjedhura si fituese.

3 Menaxhimi i financimit dhe monitorimi i performancës së projekteve

Sekretariatet teknike, sipas programeve respektive të financimit, monitorojnë performancën e autoriteteve kontraktuese në respektimin e afateve të procedurave kontraktuale.



Kryejnë vlerësimin e riskut financiar, në lidhje me situatën e përthithjes së financimit të akorduar, për projektet në sektorët përkatës dhe propozojnë reduktimin apo avancimin e financimit të projekteve, në varësi të performancës së projekteve.

Ndjekin situatën e disbursimit të fondeve, duke raportuar pranë sekretariatit të përgjithshëm, në përputhje me procedurat e përcaktuara në aktet ligjore të buxhetit.

Sipas propozimeve të sekretariateve teknike, sekretariati i përgjithshëm përgatit vendimin për miratimin e reduktimit apo avancimit të financimit, për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve.

4 Raportimi

Sekretariatet teknike raportojnë në mënyrë periodike, mujore dhe vjetore mbi rastet si më poshtë vijojnë:

- Statusin e projekteve në lidhje me respektimin e procedurave të prokurimit, shpalljen e tenderit, vlerësimin e ofertave, shpalljen e fituesve, lidhjen e kontrave dhe nisjen e zbatimit të punimeve
- Ecurinë e projekteve që nga momenti i çeljes së fondeve dhe performancën e projekteve, deri në përfundim të projektit
- Performancën vjetore të menaxhimit të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

Sekretariati i Përgjithshëm raporton në mënyrë periodike, mujore dhe vjetore në lidhje me statusin e projekteve fituese, me performancën e zbatimit të punimeve si dhe situatën e përthithjes së fondit dhe nivelin e realizueshmërisë.

VENDIM

Nr. 6, datë 9.2.2015

PËR ADMINISTRIMIN “TRANZITOR” TË PROJEKTEVE ME AUTORITET KONTRAKTUES KOMUNAT, NË PERIUDHËN SHKURT- SHTATOR 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, në zbatim të ligjit nr.115/2014, “Për ndarjen administrative territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Komunat, si autoritete kontraktuese për kontratat e nënshkruara për zbatim punimesh, duhet të sigurojnë përfundimin e zbatimit të

projekteve të financuara në vazhdim, me cikël financimi-zbatim deri në vitin 2014, përpara datës 30.6.2015. Përfundimi i punimeve përfshin dorëzimin e objektit dhe dokumentacionin përkatës tekniko - financiar për zbatimin e projektit dhe proceset e kolaudimit, kur grafiku i afateve të zbatimit të projektit e mundëson/lejon këtë, si edhe kryerjen e pagesave financiare.

2. Për komunat, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të cilat nuk arrijnë të respektojnë afatin e vendosur, do të pezullohet financimi dhe zbatim i tyre. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, të cilat burojnë nga zbatimi i kontratave të nënshkruara nga komunat për projektet me burim financimi Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, i transferohen njësisë së re të qeverisjes vendore në të cilën komuna “përthihet” sipas ndarjes së re administrative dhe territoriale, sipas ligjit nr.115/2014, datë 31.7.2015. Komunat me



projekte dhe kontrata punimesh të papërfunduara, duhet të vënë në dispozicion /transferojnë tek njësi e re territoriale që i përthith, dokumentacionin administrativ, për të gjitha fazat e ndjekura dhe të planifikuara, deri në zbatimin e plotë të kontratës.

3. Vijimi i zbatimit të projektit mund të kryhet nëpërmjet delegimit të funksioneve (kontratave) përmes marrëveshjeve të delegimit me njësi të qeverisjes vendore bashkinë qendër, e cila do të “përthithë” si njësi, në ndarjen e re territoriale, komunën autoritet kontraktues, sipas ligjit nr.115/2014, datë 31.7.2014, “Për ndarjen administrative territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

4. Financimi i projekteve të reja (përveç programit të Shqipërisë Dixhitale), gjatë vitit 2015, me vendndodhje territorin e komunave, do të kryhet për ato projekte ku aplikuesi komunë ka arritur një marrëveshje delegimi, dhe/ose partneriteti rajonal, me një prej institucioneve të mëposhtme:

a) Fondin Shqiptar të Zhvillimit;

b) këshillin e qarkut përkatës.

ku këto të fundit, si aplikant dhe autoritet kontraktues, do të zbatojnë projektin në emër

dhe për llogari të komunës në territorin e të cilës shtrihet projekti.

5. Ngarkohen sekretariatet teknike, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 392 lekë